SEFER IDRIZI

Njeriu i humbur

/roman /

Editor
Azam Dauti

SEFER IDRIZI

NJERIU I HUMBUR

/roman/

Shkupi
Shkup, 2009
3

Jeta e njeriut është det me valë. Ajo përbëhet nga mendimi, fjala dhe puna.
Shpëtimi i botës varet nga tri gjëra: të mendosh mirë, të flasësh mirë, të bësh mirë.
Fati është me ty për një orë, kundër teje për dhjetë orë.
Familja e Bashkimit jeton në qytet në një banesë prej dy dhomash, me të shoqen, Vjollcën, dhe tri fëmijët e tyre.
Përballë tyre, në një banesë më të madhe, jeton fqinji i tij, Ramizi, me të shoqen, Kumrijen, dhe dy fëmijët e tyre, vajzën Besa dhe djalin Bekim.
Këto dy familje jetonin në një harmoni të jashtëzakonshme, sikur të ishin një familje.
Ata çdo ditë, pothuajse, ishin bashkë. Të mirën dhe të keqen e ndanin bashkë, ashtu si thotë dhe populli: "Vetëm një gjumë i ndante".
Mirëpo, kohërat dhe kushtet ndryshojnë, nuk ishte më si më parë, kështu që edhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy familjeve kishin ndryshuar.
Ata kishin filluar të largoheshin prej njëri-tjetrit; ishte koha e tranzicionit në shoqëri.
Ramizi merrej me biznes privat; kishte një dyqan për shitje të auto-pjesëve, kështu që puna i shkonte mirë, kurse Bashkimi, i cili punonte në sektorin shoqëror, dita-ditës haste në vështirësi, pa rrogë të rregullt, greva, probleme të ndryshme...

Kështë, pra, këto dy familje në kohën e fundit shume rrallë mblidheshin bashkë në banesën e njërit apo tjetrit.
Kushtet kishin bërë që këta të largohen prej njëri-tjetrit.
Lakmia ia mbyllë sytë edhe më të mençurit.

Bekimet nuk vijnë kur je çift; fatkeqësitë kur je vetëm.
Ishte ditë vere, diku ora dhjetë paradite.
Bashkimi ishte ulur në tavolinë në kuzhinë dhe, si zakonisht, lexonte gazetën, kurse bashkëshortja e tij përgatiste diçka.
Fëmijët kishin dalë me shoqërinë e tyre.
Bashkimi ishte dyzet e tetë vjeç, ndërsa e shoqja dyzet e dy. Ai ishte me pushime vjetore, mirëpo, për shkak të kushteve materiale, këtë vit nuk kishin mundësi të shkonin si familje me pushime diku në det, ashtu siç kishin shkuar për vite.
Eh..., kishte kaluar ajo kohë kur familja e Bashkimit dhe ajo e Ramizit i kalonin pushimet së bashku si një familje.
Ramizi, bashkë me të shoqen dhe me fëmijët e tyre, edhe këtë vit kishte shkuar për pushime në Turqi.
Bashkimi rrinte në banesë dhe lexonte diçka.
- Vitin e kaluar në këtë kohë ishim në Shqipëri! – tha e shoqja si për të thyer atë monotoni të mërzitshme.
Me të vërtetë mbretëronte njëfarë qetësie e mërzitshme; nuk dëgjohej asnjë zhurmë tjetër

përveç zhurmave të automjeteve që vinin nga dritarja e hapur e kuzhinës.
- Po, por sivjet po piqemi në banesë! - u përgjigj Bashkimi dhe mërzitshëm ndërroi fletën e gazetës që lexonte.
- Shëndoshë se do të bëhet më mirë! - tha e shoqja.
Ajo punonte vazhdimisht rreth shporetit dhe, gjatë gjithë kohës, nuk e kthente kokën nga Bashkimi.
- Po, por do të bëhet më keq dhe jo më mirë! - u përgjigj Bashkimi. Respektivisht e kundërshtoi thënien e së shoqes, e cila ishte optimiste, ndërsa ky foli me plotë pesimizëm dhe vazhdoi më tej të shfletojë fletët e gazetës.
Pas një kohe të shkurtër, kur të dy pushuan së foluri, në kuzhinë hyri Mentori, djali më i madh i Bashkimit dhe i Vjollcës.
Mentori ishte djalë shtatlartë, njëzetvjeçar dhe ishte viti dytë në Fakultetin e Ekonomisë.
- Sot do të jetë shumë nxehtë! - tha ai, dhe u ul pranë tavolinës përballë babait të tij.
- Po, po! - pohoi me kokë Bashkimi, por pa e ngritur fare kokën nga gazeta.
- Të gjithë shokët do të shkojnë në liqen! – tha Mentori.
E tha këtë për të kërkuar leje, apo, më mirë të themi, se ai kërkonte të holla që të shkonte edhe ai me ta në liqen.
- E di që do shkojnë, por nuk kam të holla! – u përgjigj Bashkimi, i cili e dinte, e kishte të qartë, se Mentori atë e tha për të treguar se i duhen të holla.

- Unë nuk të kërkova të holla, unë vetëm të thashë! - u përgjigj Mentori me një zë më të lartë.
Ai ishte nevrikosur nga përgjigjja e të atit.
- Ngadalë, bre, mos u nxeh menjëherë! – ndërhyri Vjollca për të qetësuar situatën pak të acaruar dhe u kthye kah Bashkimi e vazhdoi të flasë: "Jepi vetëm për autobus, ai nuk të kërkon më tepër!"
- E di që nuk kërkon më tepër, por pastaj do të vijnë edhe ata të tjerët, edhe ata do të kërkojnë! - tha ai me një zë më të butë dhe lëshoi gazetën në tavolinë.
Kur tha se edhe të tjerët do të kërkojnë mendonte për dy fëmijët e tij: Liridonën, e cila ishte viti i tretë në shkollë të mesme dhe Gëzimin, djalin më të vogël, që ishte në vitin e parë në shkollë të mesme.

Liridona dhe Gëzimi ishin në të njëjtën shkollë, prandaj ata shkonin së bashku në shkollë.
- Mirë, mirë, jepi vetëm për autobus! Nëse ikin të gjithë shokët, le të shkojë edhe Mentori! - tha Vjollca me një zë shumë të butë për të qetësuar situatën.
Bashkimi mori kuletën, e hapi, nxori të hollat dhe ia zgjati Mentorit, i cili njëherë nuk dinte se çfarë të bënte, t'i merrte apo jo.
Për të mos i shqetësuar prindërit e tij, vendosi t'i merrte. Zgjati dorën, i mori të hollat, i futi në xhep dhe pastaj doli nga kuzhina.

Në kuzhinë ngelën përsëri vetëm dy bashkëshortët.
- Nuk duhet të veprosh ashtu, ata nuk kanë faj! - tha Vjollca.
- E di, e di, por nuk del. E sheh edhe vetë se nuk po na japin rrogë me rregull, e llogaritë duhet të paguhen, rryma, uji, telefoni! – u përgjigj
Bashkimi.
- Po, po, e di, por çfarë të bësh! – pohoi Vjollca, dhe pastaj vazhdoi: - Me të vërtetë ç'do të bëhet me sipërmarrjen tuaj?
Pyeti ajo që tanimë ishte e papunë.

Ajo ishte ulur në një karrige afër tavolinës dhe priste se ç'do të thoshte ai.
- Se çfarë do të bëhet as unë nuk e di, ende punojmë ashtu si pa kokë, flitet se do të privatizohet, por ende nuk ka të interesuar që duan ta blejnë fabrikën, për shkak se ka shumë humbje! – tha Bashkimi, në fytyrën e të cilit vërehej brengosje.
Atë e brengoste shumë kjo gjendje, kjo situatë në punë, pa rrogë, i punësuar, por pa punë.
- Me siguri kanë për të nxjerrë edhe nga puna? – pyeti Vjollca plot kureshtje. Ajo frikësohej për fatin e Bashkimit, çfarë do të ndodhte me të,
nëse e nxirrnin si tepricë teknologjike.
- Me siguri që po, e kjo po më brengos më tepër! – u përgjigj Bashkimi.

Në kuzhinë mbretëroi një qetësi, nga jashtë dëgjohej zhurma e mërzitshme e automjeteve, asnjëri nuk foli më, të dy ishin ulur pranë tavolinës përballë njëri-tjetrit.
Bashkimi ishte elektro-inxhinier dhe gati tetëmbëdhjetë vjet punonte në fabrikën e autobusëve, e cila viteve të fundit më tepër nuk punonte se sa punonte.
Punëtorët shpesh bënin grevë, ndërprisnin punën dhe dilnin në rrugë.
- Babiiii! – u dëgjua një thirrje nga jashtë.
Të dy, ashtu siç ishin duke menduar, brofën në këmbë, sepse zëri ishte trishtues dhe i njohur për ta, ishte zëri i Liridonës.
- Babii! – u dëgjua përsëri ai zë.
- Çfarë u bë, çfarë ndodhi?! – pyeti Bashkimi duke dalë nga kuzhina, gati sa vraponte, e pas tij doli edhe Vjollca.
Nga ana tjetër, nga dera e hyrjes hynte Liridona, edhe ajo gati duke vrapuar dhe në të njëjtën kohë bërtiti: - Gëzimi!
Ajo ishte duke u mbushur me frymë dhe nuk mundej të fliste.
- Çfarë ka Gëzimi, moj, fol?!! – pyeti Vjollca, e cila ishte pas shpinës së Bashkimit.
- Gëzimin e shtypi një veturë! – u përgjigj Liridona me një zë vajtues, kurse fytyra i ishte zbehur nga trishtimi.
- Si, moj, ku është? – pyeti Bashkimi i frikësuar dhe në fytyrë nuk i kishte ngelur asnjë pikë gjaku.

Vjollca ishte ulur në vend, ishte rrëzuar nuk mund të fliste fare.
- E dërguan në spital! – u përgjigj Liridona.
Bashkimi, i cili e kishte kapur me të dyja duart për krahësh Liridonën, e pyeti: - Trego, moj, a është gjallë?!
- Mos u frikësoni nuk është lënduar shumë. Pasi e shtypi vetura, ai foli me mua kur u afrova ta shoh dhe më tha: "Nuk kam asgjë, jam mirë!", dhe pastaj e morën disa njerëz, e futën në veturën e tyre dhe e dërguan në spital! – u përgjigj Liridona gati me një frymë, pa ndërprerje.
Pas kësaj që tha Liridona, atij iu lehtësua pak, doli nga banesa, si duket u nis për në spital.
Atëherë Liridona e vërejti nënën e saj që ishte rrëzuar në korridor.
- Nënë, a je mirë? – pyeti Liridona, duke u ulur pranë saj.
Nëna qante, por në heshtje, nuk lëshonte zë.
- Më trego, bij e nënës, a është gjallë? – pyeste ajo vazhdimisht duke qarë.
- Mirë është, moj nënë, mos qaj, nuk është shumë i lënduar! – u përgjigj Liridona dhe pastaj u çuan të dyja dhe së bashku hynë në kuzhinë krah për krahu.
Liridona e uli nënën në karrige dhe pastaj i solli një gotë me ujë që të freskohej pak nga ajo që kishte përjetuar.
Pasi piu pak ujë nëna psherëtiu: "Ah, e shkreta unë ç'më ndodhi!" – tha ajo duke fshirë lotët.

- Mos fol ashtu, nënë, se Gëzimi do të shërohet, nuk është shumë i lënduar! – tha Liridona për t'i dhëne kurajë së ëmës.
Pastaj edhe Liridona u ul në karrige dhe të dyja rrinin të menduara, nuk kishin fuqi të flisnin, ishin në pritje, prisnin të kthehej Bashkimi nga spitali që t'u sjellë lajme për gjendjen e Gëzimit.
Qëndruan kështu për një kohë të gjatë, por siç thotë një fjalë popullore: "E keqja merret vesh menjëherë", edhe në këtë rast u vërtetua kjo fjalë.
Mentori, i cili ishte nisur me shokët për në liqen, rrugës kishte marrë vesh për fatkeqësinë që i kishte ndodhur Gëzimit, prandaj diku në mes të rrugës ai ishte kthyer sërish në shtëpi.
Derisa këto të dyja rrinin ulur pranë tavolinës dhe mendonin me padurim që Bashkimi të hapte derën dhe t'i sillte atë lajm të shumëpritur, dera u hap, por nuk ishte Bashkimi, ishte Mentori, i cili u kthye në shtëpi.
Hyri në kuzhinë gati duke vrapuar.
- Gëzimi ku është, çfarë ka ndodhur?! – pyeti ai duke u mbushur me frymë, ngase kishte vrapuar shumë rrugës.
Liridona u ngrit në këmbë.
- Mos u shqetëso, vëlla, qetësohu! – tha ajo duke u lëshuar në përqafim të Mentorit.
- Ku është, ku është?! – pyeste Mentori pandërprerë.
- Në spital është, vëlla, nuk është shumë i lënduar! - u përgjigj Liridona dhe e përqafoi fort Mentorin, të cilit filluan t'i rridhnin lotët vetvetiu.

Qante edhe nëna, e cila i vështronte motër e vëlla të përqafuar dhe përnjëherë i shkoi mendja tek Gëzimi.
Mentori u ul pranë tavolinës në një karrige pranë nënës së tij, kurse Liridona mori një gotë dhe e mbushi me ujë dhe ia solli Mentorit.
Të tre ishin ulur pranë tavolinës dhe nuk flisnin asgjë, me padurim prisnin të kthehej Bashkimi dhe t'i sillte ndonjë lajm nga Gëzimi.
Pas një kohe të gjatë u hap dera e jashtme, të gjithë u bënë krejt vesh, prisnin se kush do të hyjë dhe kur u hap dera e kuzhinës panë se ishte Bashkimi, të tre u ngritën nga vendet e tyre.
- Trego si është, a është gjallë?! - pyeti Vjollca me një zë të frikësuar, dridhës.
Kurse Mentori dhe Liridona nuk folën fare, por kuptohet prisnin të njëjtën përgjigje.
- Mirë është, gjallë, nuk është shumë i lënduar! - u përgjigj Bashkimi dhe kërkoi një karrige për t'u ulur, sepse edhe ky ishte lodhur shumë.
Edhe ata të tre u ulën, e ndjenin veten më të lirë nga ai ankth i pritjes, tani merrnin frymë më lehtë.
- Babi, a është mirë, trego?! - pyeti Mentori. Ai donte të dinte diçka më tepër, nuk mjaftonte ajo që tha babai i tij.
- Po, po, mirë është, bisedova me të, i ishin lënduar këmbët dhe koka, por mirë është! – u përgjigj Bashkimi.
- Shyqyr Zotit! – tha Vjollca, ofshau njëherë dhe sikur u lirua nga një barrë e rëndë.
- Babi këmbët i kishte shumë të lënduara? – pyeti Liridona.

Ajo mendoi të pyesë se mos vallë i ka të thyera, por kjo shprehje iu duk shumë e vrazhdë, as që donte të mendonte për një gjë të tillë.
- Jo, jo, bija ime, nuk i ka të lënduara shumë, nuk i ka të thyera! – tha Bashkimi dhe pas kësaj që tha edhe ai e ndjeu veten më mirë, më lehtë, u lirua nga një barrë e rëndë, një gurë i ra nga zemra.
Pasi që dëgjuan për gjendjen e Gëzimit, nuk kishin më se çfarë të pyesin, tanimë ishin të gjithë të qetë.
Papritur u dëgjua cingërima e telefonit, të gjithë u frikësuan shumë, asnjëri nuk mundej të çohej nga vendi, rrinin të habitur dhe vështronin njëri-tjetrin, të gjithë i mundonte në këtë moment pyetja se kush mund të ishte?!
Mos vallë lajmërohen nga spitali, por jo, menjëherë e inkurajonin vetveten. Bashkimi u tha se Gëzimi është mirë, kush do të jetë ky që po telefonon në këtë moment… Më në fund Liridona u ngrit nga karrigia, u afrua afër telefonit, ngriti receptorin dhe tha: - Alo, urdhëroni!
Në anën tjetër të telefonit ishte gjyshi i saj nga fshati, i cili, menjëherë pasi që kishte marrë vesh për fatkeqësinë e Gëzimit, kishte hapur telefonin për të parë nëse është e vërtetë ajo që kishte dëgjuar.
Por kur Liridona i tregoi se është e vërtetë, ai tha se do të vijë menjëherë t'i vizitojë.
Pasi u përshëndetën Liridona e lëshoi receptorin në telefon.
- Gjyshi ishte? – e pyeti nëna Liridonën.

- Po, gjyshi ishte! – u përgjigj ajo.
- Çudi sa shpejt është përhapur lajmi edhe në fshat! – tha Bashkimi.
- Çfarë të tha, do të vijnë? – pyeti përsëri nëna.
- Po, si duket do të vijnë të dy, do të vijë edhe gjyshja! - u përgjigj Liridona.
Ata qëndruan ulur pranë tavolinës për një kohë të gjatë, biseduan për shumë gjëra.
Papritur u dëgjua zilja e jashtme.
- Gjyshi! – tha Liridona dhe u ngrit të hapi derën, të tjerët ngelën në pritje se kush do të jetë, por edhe ata atë mendonin, madje ishin të sigurt se ata që i ranë ziles janë gjyshi dhe gjyshja.
Dhe me të vërtetë kur Liridona e hapi derën aty ishin gjyshi dhe gjyshja nga fshati.
- Urdhëroni, hyni – i ftoi Liridona.
- Ç'ndodhi moj bijë, si është Gëzimi!? – pyeti gjyshi duke hequr këpucët, pas tij hyri edhe gjyshja.
- Mirë është, gjysh, nuk është lënduar shumë – u përgjigj Liridona.
Në të njëjtën kohë në derë të kuzhinës kishin dalë të tre: Bashkimi, Vjollca dhe Mentori për të pritur mysafirët e porsaardhur.
- Ku është Gëzimi? – pyeti gjyshja.
- Në spital është, gjyshe, por mirë është! – u përgjigj Liridona.
- Ah, nipi im ç'të gjeti! – tha gjyshja.
- Nënë, mos qaj se Gëzimi mirë është! – tha Vjollca dhe e përqafoi nënën e saj.
Edhe Bashkimi u përshëndet me gjyshin dhe pastaj të dy i ftoi të hyjnë në dhomën e ndenjes.

Pasi hynë të gjithë brenda dhe u ulën, për një kohë të gjatë biseduan për shumë gjëra, por kuptohet biseda e tyre më shumë sillej rreth fatkeqësisë së Gëzimit.

Ata qëndruan gati dy orë dhe pastaj u kthyen në fshat.
Atë pasdite të gjithë anëtarët e familjes së Bashkimit e kaluan bashkë në banesë, edhe pse ishte shumë nxehtë ata nuk e vërenin aspak këtë gjë, gjithë kohën bisedonin me njëri-tjetrin për gjëra të ndryshme.
Biseduan edhe për atë se të nesërmen Vjollca me Liridonën që në mëngjes do të shkonin në spital për të vizituar Gëzimin.
Ilaçi më i mirë për kohët e fatkeqësisë është durimi.
Të nesërmen, pasi kryen punët e zakonshme të shtëpisë, Vjollca dhe Liridona u nisën për në spital, ato donin t'i bënin një vizitë Gëzimit.
Rrugës blenë diçka për Gëzimin dhe shkuan në spital.
Ishte ditë kur nuk ishte e lejuar vizita në spital, mirëpo mjeku kujdestar ishte shok i Bashkimit, prandaj i lejoi të hyjnë brenda.
- Gëzim, bir i nënës, ku të kam! – tha Vjollca dhe e përqafoi Gëzimin, i cili nuk mund të çohej.
- Mirë jam, nënë, ja siç më sheh në spital!- u përgjigj Gëzimi.

Pastaj me Gëzimin u përshëndet edhe Liridona, e cila gjithashtu e përqafoi fort vëllanë e saj.
Ata qëndruan një kohë të shkurtër aty, biseduan për disa gjëra, por kuptohet më shumë për atë se si i ndodhi Gëzimit kjo fatkeqësi dhe se çfarë i thonë mjekët.
Gëzimi u tregoi gjer e gjatë, ai gjithashtu u tregoi se pas dy ditësh do ta dërgojnë në shtëpi, pasi nuk ka lëndime të mëdha.
Pastaj ato të dyja, nënë e bijë, pasi u qetësuan që Gëzimi ishte mirë, u kthyen në shtëpi.
Sot në mëngjes Ramizi, fqinji i Bashkimit, ishte kthyer nga pushimet në Turqi, prandaj ky kishte vendosur ta vizitojë, sepse e kishte fqinj të parë dhe gjatë kësaj kohe nuk kishte hyrë në banesën e tij. Bashkimi i ra ziles dhe priste të hapej dera, pas një kohe derën e hapi e shoqja e Ramizit, Kumrija.
- Urdhëro Bashkim! – e ftoi ajo të hyjë brenda.
- U kthyet nga Turqia? – pyeti Bashkimi duke hyrë brenda, ketë e tha vetëm sa për të filluar bisedën.
Në dhomën e pritjes Ramizi ishte çuar në këmbë dhe po priste Bashkimin të hyjë.
Kur hyri Bashkimi ata të dy u përshëndetën dhe u ulën pranë tavolinës.
Bashkimi gjithë kohën, ndërsa bisedonte me Ramizin, vështronte banesën përreth, e cila me të vërtetë ishte shumë komforte, e përbërë prej tre dhomave me mobilie të reja.
Në vete Bashkimi mendonte se si është e mundur që ky njeri të krijojë këtë pasuri, atë filluan ta brejnë mendime të ndryshme, filloi të

dyshojë në ndershmërinë e këtij njeriu përballë tij.
- Si kaluat në Turqi? – pyeti Bashkimi.
- Shumë mirë, shkëlqyeshëm – u përgjigj Ramizi
- A ishte shtrenjtë vendosja, ushqimi? - pyeti përsëri Bashkimi.
- Jo, aspak! Përkundrazi, më duket se ishte shumë lirë! - u përgjigj Ramizi.
- Po, po lirë për shkak se ke! - pohoi Bashkimi.
Ramizi me të vërtetë kishte shumë të holla, puna në dyqanin për auto-pjesë i shkonte shumë mirë, prandaj ai nuk kishte problem të shkonte për pushime atje ku kishte dëshirë.
- Po ti Bashkim ishe diku me familjen për pushime, apo jo?! – pyeti Ramizi, ashtu vetëm formalisht për shkak se edhe vetë e dinte se në çfarë gjendje financiare ishte Bashkimi.
- Jo këtë vit nuk pata mundësi të shkoj diku, nuk del, rrogë jo me rregull! - tha Bashkimi disi i thelluar në mendime. Ai ishte shumë i brengosur nga kjo situatë pa zgjidhje.
Ndërkohë Kumrija u solli kafet dhe pijet që të freskohen.
Ndërsa pinin kafe, ata biseduan gjatë kësaj kohe për gjithçka, për familjet e tyre, politikën, situatën ekonomike dhe punët e tyre.
Pak më vonë Bashkimi u ngrit dhe, pasi u përshëndet, doli nga banesa e tyre.
Ditët kalonin njëra pas tjetrës, ditë të njëjta, të nxehta dhe të gjata për këtë familje, e cila më parë, çdo vit, shkonte për verime, për pushim diku, kurse këtë vit gjendja materiale kishte bërë që të rrinë, të digjen në banesën e tyre të nxehtë.

Kaloi edhe kjo verë e nxehtë, mbaruan pushimet, Bashkimi kishte filluar të shkojë në punë, kurse fëmijët e tij në shkollë, Mentori dëgjonte ligjëratat në vitin e tretë, Liridona ishte maturante, kurse Gëzimi në vitin e dytë në të njëjtën shkollë.

Bashkimi shkonte në punë, por nuk punonte, sepse në fabrikë ku punonte ai çdo ditë kishte grevë, tanimë kishin nxjerrë edhe listat e punëtorëve të cilët ishin tepricë teknologjike, e në atë listë ishte edhe Bashkimi.

Ai për këtë nuk tregonte në shtëpi, sepse e dinte që ai lajm do t'i shqetësojë të gjithë, por ajo vërehej ditëve të fundit, ai ishte bërë shumë nervoz ndaj çdo gjëje, ndaj çdo imtësie reagonte vrullshëm.

- Lëre mos e ndërro programin! – bërtiti me një zë trishtues Bashkimi.

Gëzimi u frikësua shumë saqë kërceu nga vendi.

- Po në programin tjetër ka transmetim të ndeshjes së futbollit, babi! – tha Gëzimi me një zë lutës.

- Unë të them mos e ndërro, dua të dëgjoj lajmet! - tha Bashkimi shumë prerë.

Gëzimi ngeli i shtanguar pranë televizorit, nuk dinte se ç'të bënte.

- Futboll, çfarë më duhet futbolli kur nuk do të kemi se ç'të hamë! – tha ai dhe uli kokën, sepse si duket edhe atij i erdhi keq që bërtiti.

Në atë moment nga kuzhina hyri Vjollca, e cila kishte dëgjuar këtë bisedë, pikërisht zërin e lartë të Bashkimit.

- Mirë, bre burrë, ti deri tani dëgjove lajme, lëre djalin të shikojë futboll! – tha Vjollca me një zë qortues që dukej se qortonte të shoqin.
- Jo, nuk ka problem! – tha Gëzimi dhe pastaj vazhdoi: - Unë do të dal, do të shkoj tek një shok! - dhe doli me shpejtësi nga dhoma.
Në dhomë ngelën dy bashkëshortët.
- Ja çfarë bëre, e nxore në rrugë! – i tha Vjollca.
- Mirë de, gabova, por çfarë të bëj, edhe unë nuk e kam të lehtë! – filloi të arsyetohet Bashkimi, edhe ai tani e kishte të qartë se gaboi dhe se nuk duhej të reagonte në atë mënyrë.
- Me ato lajme na ke lodhur të gjithëve! – tha Vjollca.
- E di që ju kam lodhur, por edhe vetë jam lodhur dhe nuk di se çfarë të bëj, nuk e di se ç'do të bëhet, a do të ngelem në punë apo do të më largojnë! – tha ai dhe u ndal pak për një moment. Si duket edhe ai vetë u pendua që e tha këtë.
- Jo, nuk të largojnë ty nga puna. Ti ke një kohë të gjatë që punon aty! – tha Vjollca e trishtuar, edhe ajo nuk mund të besonte se mund të ndodhte një gjë e tillë.
- Po, po, mundën të më nxjerrin, i kanë nxjerrë listat e në ato lista isha edhe unë – u përgjigj Bashkimi.
- Mirë, e pse nuk ke treguar? – pyeti përsëri Vjollca.
- Nuk doja t'u shqetësoja, t'u ngarkoj me problemet e mia! – u përgjigj Bashkimi.
- Jo, burrë! Ai nuk është vetëm problemi yt, ai është problem i të gjithë neve, të gjithëve na

brengos ajo, por shëndosh se gjithçka do të bëhet mirë! – tha Vjollca dhe doli nga dhoma.
Dikush i ra ziles, Vjollca ishte vetëm në kuzhinë, ishte duke punuar diçka, u frikësua shumë.
Kush mund të jetë, kush i ra ziles, mendime të ndryshme i silleshin tani asaj në kokë, mos vallë ka ndodhur diçka?
U nis ngadalë kah dera, e hapi dhe u habit kur pa nënën e saj.
- Nënë, vetëm je? – pyeti ajo, sepse edhe vetë e shihte se nuk ishte askush tjetër me të.
- Po, bijë, vetëm jam. – u përgjigj nëna dhe të dyja u përqafuan.
- Po babi si është? – pyeti Vjollca. Donte të thoshte ku është ai, sepse çdo herë që vinin në qytet ata vinin bashkë.
- Në spital, bijë! – u përgjigj nëna.
- Po si, ç'ndodhi? – pyeti Vjollca dhe njëkohësisht, në atë moment, trupin ia përshkuan ethet, u frikësua shumë, ai plak është, mendonte ajo, tani dhe çdo gjë mund të ndodhë.
Frikohej nga më e keqja, vdekja!
- Nuk e di, moj bijë, ankohet nga zemra! – u përgjigj nëna.
Në atë kohë erdhi edhe Bashkimi, i cili pasi u përshëndet, u ul në një karrige.
- Kush është në spital? – pyeti ai për të filluar bisedën, sepse kishte dëgjuar diçka.
- Babai im është në spital. – u përgjigj Vjollca.
- Nga se ankohet? – pyeti Bashkimi, edhe ai u brengos shumë kur dëgjoi këtë lajm, e kjo vërehej në fytyrën e tij të zbehte që tani edhe më tepër ishte zverdhur.

- Nga zemra ankohet, bre dhëndër, por nuk e di, do të shohim se çfarë do të tregojnë rezultatet! – u përgjigj plaka.
- Bashkim, unë me nënën do të shkoj në spital! – tha Vjollca.
Si duket në njëfarë mënyrë ajo kërkonte leje nga bashkëshorti që të shkonte.
- Mirë, mirë, shkoni. – u përgjigj Bashkimi
Për një kohë të shkurtër asnjëri nuk foli, të gjithë ishin thelluar në mendime, secili në kokën e tij bënte plane për të vepruar më tej.
Por ishte e qartë për ta, se këto çaste janë shumë të gjata, mosha e plakut, zemra e tij e sëmurë, frikoheshin mos vallë ndodhte më e keqja.
Të dy gratë dolën nga banesa, Bashkimi ngeli vetëm.
Ai tani gati sa me zë kishte filluar të fliste me veten, nuk ishte askush dhe ai zëshëm mendonte për të gjitha problemet.
Greva e punëtorëve ishte zgjeruar, ata tanimë nuk bënin grevë në fabrikë, por gati çdo ditë dilnin në rrugët e qytetit.
Një ndër organizatorët e grevës ishte edhe Bashkimi.

Po ece shpejtë arrin fatkeqësinë, po ece ngadalë të arrin ajo.
Në kuzhinë ishin ulur Vjollca, Mentori dhe Liridona.
Gëzimi ende nuk kishte ardhur, gjë e zakonshme për të kohët e fundit, ishin mësuar

të gjithë me të, e dinin se ai çdo ditë vonohej diku.
Por më shumë i brengoste vonesa e Bashkimit, ai çdo ditë kthehej herët në shtëpi, kurse sot ja ora është tetë e mbrëmjes dhe ai ende nuk ishte kthyer nga puna.
Të tre rrinin ulur në kuzhinë, prisnin të kthehej Bashkimi për të ngrënë darkën.
Duke ndenjur ashtu të menduar, pa folur fare me njëri-tjetrin, qetësinë e prishi cingërima e telefonit, u trishtuan shumë.
Shikonin njeri-tjetrin, nuk dinin në atë moment se si të vepronin, secili priste që të çohej tjetri për të kapur telefonin, secili frikohej se mos vallë dëgjonte nga ana tjetër e telefonit për ndonjë gjë të keqe, për ndonjë fatkeqësi, Bashkimi nuk ishte kthyer.
U ngrit Liridona, kapi receptorin dhe foli: Alo! - tha ajo dhe u ndal, dëgjonte, sepse nga ana tjetër e linjës fliste një njeri.
Nëna dhe Mentori u bënë krejt veshë, dëgjonin se mos vallë dëgjojnë ndonjë fjalë.
- Të kërkojnë ty, nënë! – tha Liridona dhe ia dha receptorin nënës.
Nëna e brengosur dhe nga kureshtja se kush mund të ishte, ishte zverdhur shumë në fytyrë saqë nuk i kishte ngelur pikë gjaku në të.
Kush do të jetë, pse po më kërkon, a thua ç'ka ndodhur, të gjitha këto pyetje silleshin nëpër kokën e plakës.
- Po, urdhëroni! – tha ajo dhe pastaj heshti, dëgjonte se çfarë fliste personi nga ana tjetër e linjës.
- Mirë…, mirë! – tha ajo dhe pastaj lëshoi receptorin në telefon.

- Kush ishte nënë? – pyeti Mentori
- Nga policia ishte! – u përgjigj nëna.
- Nga policia, e çfarë kërkonte?! – pyeti përsëri Mentori, kurse në mendjen e tij i silleshin vërdallë shumë gjëra në lidhje me babanë e tij, mosardhja e tij, diçka kishte ndodhur, po, por diçka do të ketë ndodhur mendonte ai derisa priste përgjigjen nga nëna.
- Bashkimin e paskan arrestuar! – u përgjigj Vjollca dhe uli kokën.
- Pse nënë, nuk të treguan? – pyeti Mentori.
- Jo, nuk më tregoi vetëm më tha që të shkoj në stacionin e policisë! – u përgjigj Vjollca.
Të tre nuk folën më fare, ishin këto çaste të vështira për ta, rrinin ulur njëri pranë tjetrit dhe mendonin secili në kokën e tij duke analizuar gjërat, i analizonin të gjitha ngjarjet.
Mundoheshin të gjenin arsyen e burgosjes së Bashkimit.
Gëzimi nuk ishte kthyer ende, këtë as që e vërente ndonjëri prej tyre, ishin mësuar tani me të. Kohët e fundit Gëzimi ishte i çuditshëm, me të sikur ndodhte diçka, shumë rrallë shihej me njerëzit e familjes së tij.
Ishte i tërhequr në vete, nuk bisedonte me askënd.
Askush nuk e dinte se ku shkonte, ku e kalonte kohën dhe cilët ishin shokët e tij me të cilët shoqërohej.
Dikur shumë vonë ata kishin rënë të flenë, edhe pse askujt nuk i flihej.

Të nesërmen herët në mëngjes Vjollca shkoi në stacionin e policisë. Asaj i kishin kërkuar letërnjoftimin e Bashkimit.
Pas evidentimit të të dhënave të Bashkimit, për të cilën e kishin kërkuar letërnjoftimin e tij që ta sjellë Vjollca, policët e liruan Bashkimin që të shkojë në shtëpi.
Të dy së bashku u nisën për në shtëpi, rrugës nuk flisnin fare, analizonin të gjitha gjërat, mendonin se si të veprojnë më tej.
Pas një kohe ata arritën në banesën e tyre.
- Pse, bre burrë, përzihesh në punë që nuk duhet?! - tha Vjollca për të filluar bisedën.
- Si të mos përzihem kur bëhet fjalë për fatin tim! - u përgjigj Bashkimi.
- Përzihesh, por ja se ç'ndodh! – tha Vjollca, e cila mendonte në atë se ja të merr policia dhe se nëse edhe më tej vazhdon me atë aktivitet mund të të burgosë.
- Ç'të ndodhë për të tjerët, le të ndodh edhe për mua! – tha Bashkimi dhe u ul në një karrige aty në dhomën e ndenjes, kurse Vjollca hyri në kuzhinë që të kryejë punët e saj të përditshme dhe t'i përgatiste diçka Bashkimit për mëngjes, sepse e dinte se ai prej ditës së djeshme nuk kishte ngrënë asgjë.
Ai nuk shkoi në punë atë ditë dhe, pasi pushoi pak, doli në qytet të shohë se mos vallë gjen ndonjë punë.
Ai dilte në qytet shpesh ditëve të fundit për të kërkuar ndonjë punë, sepse në fabrikë nuk punonin fare, e kishin ndërprerë përfundimisht punën.

Diçka e pambrojtur është e sigurt nëse e ruan fati, por po qe fati kundër saj, do të humbasë sado të ruhet.
Në çfarë gjendje kishte ardhur Bashkimi, deri para një viti jetonte si zotëri, kurse tani është i detyruar të punojë si argat ndokund për të siguruar ekzistencën e familjes së tij.
Ishte mbështetur tek një mur në tregun e punës, ashtu e quanin njerëzit vendin ku shumë të rinj prisnin që dikush t'i angazhojë për të kryer ndonjë punë, dhe ja edhe ai tani ishte këtu dhe priste që dikush ta thërrasë për ndonjë punë.
Ai nuk zgjidhte se çfarë do të punojë. Ai pranonte çfarëdo pune, edhe pse ishte inxhinier, vetëm të nxirrte diçka.
E kishte shumë të vështirë, nuk ishte mësuar të kërkonte punë në atë mënyrë, por nuk kishte rrugëdalje tjetër.

Jetë, o jetë! Deri në çfarë derexheje ka ardhur Bashkimi?! Ka ardhur në skaj, është mbështetur me shpinë për muri, me tej më nuk ka se ku të shkojë… Eh, elektro-inxhinier i dikurshëm, çfarë fati!
Duke ndenjur aty nga ana tjetër e rrugës vërejti Gëzimin me disa shokë të tij, u shqetësua shumë dhe menjëherë u nis të kalojë rrugën.
Dukej sikur vraponte, me hapa të shpejtë ecte drejt tij, frikohej se do ta humbiste, se do ta humbiste Gëzimin në turmën e njerëzve.

E kaloi rrugën dhe i doli përpara Gëzimit.
- Ku shkon? – e pyeti ai i habitur nga pamja e tij.
- Askund vetëm kemi dalë të shëtisim! – u përgjigj Gëzimi i habitur nga ky takim i papritur me babanë e tij.
- Si askund, a nuk je në shkollë? - pyeti ai përsëri dhe me bisht të syrit vështronte tre shokët e tij, të cilët, për nga pamja e tyre, nuk i pëlqenin aspak.
Në vesh kishin vathë, pantallonat e shqyera dhe flokët e gjata që dukeshin sikur kishin muaj që nuk i kishin larë.
- Isha në shkollë, por dolëm më herët! – u përgjigj Gëzimi, gjithnjë duke shikuar anash, sepse nuk po tregonte të vërtetën.
- Për këtë do të bisedojmë në shtëpi, por edhe për shumë gjëra të tjera, mos u vono shumë! - i tha Bashkimi me një zë qortues, sepse ai me të vërtetë me Gëzimin duhej të bisedonte për shumë gjëra.
Ai kohet e fundit sillej shumë çuditshëm, kthehej vonë në shtëpi, nuk bisedonte me asnjë person të familjes.
Bashkimi atë ditë nuk gjeti punë fare, ndenji në treg deri në ora tre të pasdites, por askush nuk erdhi t'i ofronte ndonjë punë.
Ishte kthyer pasdite në banesë dhe si zakonisht ishte ulur në dhomën e ndenjes dhe shikonte televizorin.
- Nuk gjete punë?! - pyeti Vjollca për të prishur atë monotoni, për të filluar bisedën.
- Jo, nuk gjeta, është e vështirë, çdo ditë e më pak ka punë! - u përgjigj Bashkimi.

- Shëndoshë, ç'të bësh! – tha Vjollca dhe doli nga dhoma.
Bashkimi vetëm tundi kokën në shenjë pajtimi.
Edhe ai ishte i mendimit se me të vërtetë më me rëndësi është të jesh shëndoshë e mirë se të gjitha gjërave të tjera u bëhet qarja, për çdo gjë ka zgjidhje.
Diku aty para se të errësohej, erdhi Gëzimi. Mentori dhe Liridona ende nuk ishin kthyer, kurse ky sot u kthye i pari në shtëpi.
Si duket e mbajti fjalën që i dha të atit se do të kthehet më herët.
Hyri në dhomë ku ishte babai i tij, por nuk u ndal, vazhdoi drejt dhomës së tij.
- Ku shkon?! – e pyeti babai, kur vërejti se ky as që e përshëndeti, por ishte nisur drejt dhomës së tij.
- Në dhomë! – u përgjigj Gëzimi, mendonte në dhomën e tij.
- Jo! – ia preu shkurt Bashkimi dhe pastaj vazhdoi: - Ulu këtu se duhet të bisedojmë!
Gëzimi tërhoqi një karrige që e kishte afër, u ul dhe priste se çfarë do t'i thoshte i ati.
Edhe pse deri diku ai mundej të paramendonte se për çfarë do të bisedonin, e kishte edhe ai të qartë se çfarë pyetje do t'i parashtronte tani ai.
- Pse nuk më përshëndete kur hyre, ç'është kjo që po ndodh me ty?! – pyeti Bashkimi.
Ai kishte edhe shumë pyetje të tjera për të cilat sot si duket kishte ardhur dita që të merrte përgjigje prej tij.
- Më fal, harrova! – u përgjigj Gëzimi dhe ngriti supet në shenjë çudie, sikur donte të thoshte

se nuk e di se përse nuk të përshëndeta dhe se nuk e di se çfarë ndodh me të.
- Harrove, e pse i shmangesh takimit me mua? – pyeti përsëri Bashkimi.
Gëzimi nuk foli fare, por vetëm uli kokën dhe shikimin e kishte diku në dysheme, nuk dinte se çfarë të thoshte, nuk dinte se çfarë përgjigje t'i jepte.
E kishte të qartë edhe ai se është fajtor.
- Ç'është kjo bisede që dëgjoj? – pyeti Vjollca duke hyrë nga dera e kuzhinës.
- Asgjë, një bisedë e thjeshtë dhe shumë e nevojshme me Gëzimin! – u përgjigj Bashkimi.
Kurse Gëzimi nuk foli fare, qëndronte ende kokulur, ishte në pozitën e një të akuzuari që ka bërë ndonjë vepër penale.
- Gëzim qenke kthyer herët sonte? – pyeti Vjollca, e cila dukej sikur tani e vërejti këtë.
- Po, më tha babi që të kthehem më herët! – u përgjigj Gëzimi, i cili nuk e ngriti kokën fare.
Ai frikohej se mos vallë shikimi i takohej me atë të prindërve të tij.
Frikohej prej shikimit të tyre se mos vallë në sytë e tij do të zbulojnë atë fshehtësinë që ai nuk kishte fare dëshirë që ta zbulojnë, por një ditë ata do të kuptojnë çdo gjë.
Ai nuk donte t'u shkaktojë dhimbje atyre, nuk donte t'i lëndonte, por një ditë doemos ata do ta kuptojnë fshehtësinë e tij të madhe.
Si do ta pranojnë ata atë lajm, si do të reagojnë, kjo e frikësonte shumë Gëzimin.
Ishte kjo një enigme e madhe për të saqë, kur e mendonte, i dukej se do t'i pëlciste koka nga barra e rëndë, nga pyetjet pa përgjigje, të cilat

nuk donte që ndonjëri prej të afërmeve të tij t'i kuptojë, të kuptojë atë të vërtetë të hidhur.
- Gëzim, ti kohët e fundit ke sjellje të çuditshme, ç'po ndodh me ty, trego!? – pyeti Bashkimi, por tani me një zë më të ulët, gati sa lutës.
- Asgjë, unë nuk e di se çfarë keni ju, pse po me pyesni! – bërtiti Gëzimi i shqetësuar dhe u çua në këmbë, kurse fytyra e tij ishte zverdhur shumë e nëpër ballë i dilnin djersë të ftohta.
- Qetësohu, Gëzim, përgjigju pyetjeve të babait! – tha Vjollca duke u afruar afër tij dhe pastaj e kapi për njërin krah.
- Unë nuk kam asgjë, nuk e di për çfarë po më pyesni?! – u përgjigj përsëri Gëzimi.
- E di ti shumë mirë, e di ti! – tha Bashkimi dhe brofi në këmbë.
Ishte nervozuar shumë dhe gjatë gjithë kohës, ndërsa fliste, ia tërhiqte vërejtjen Gëzimit me gisht.
Në atë moment në dhomë hyri Liridona, e cila, kur dëgjoi ato fjalë të babait të saj, u shtang në vend, nuk dinte se ç'të bënte, të hynte brenda apo të kthehej prapa dhe të dalë jashtë.
- Mirë që erdhe ti! – tha Bashkimi dhe u kthye nga Liridona dhe vazhdoi: - Më trego, a ka ardhur me rregull në shkollë ky, më trego drejtë?
- Nuk e di, mendoj se po, por disa ditë nuk e kam gjetur në klasë kur e kam kërkuar, por nuk e di! – u përgjigj Liridona, e cila nuk dinte se çfarë të bënte, si të përgjigjej.

Të tregonte të vërtetën, i dhimbsej vëllai i vogël, por edhe babai, të cilit po t'i tregonte të vërtetën do të nervozohej edhe më tepër.
Të gënjente nuk guxonte, sepse edhe ajo frikohej për fatin e vëllait, e dinte se diçka ndodhte me të, se nuk ishte i rregullt në shkollë, se shoqërohej me disa shokë që nuk i pëlqenin as asaj.
- Nuk e di ti, nuk e di ai, ajo, e kush e di, dikush duhet ta dijë diçka, me të ndodh diçka, nuk vjen në kohë në shtëpi, nuk flet me askënd! A e dini se me kë e kam parë sot? Me disa shokë, që unë nuk do t'i kisha quajtur njerëz e jo më të shoqërohem me ta! – mbaroi rrëfimin Bashkimi dhe priste që ndonjëri të përgjigjet.
- Qetësohu, Bashkim, mos e ngri zërin! – e luste Vjollca atë dhe pastaj u kthye kah Gëzimi: - Trego, bir, çfarë po ndodh me ty, pse nuk flet, kush janë ata shokë? - e luti nëna me një zë të butë e qetësues.
Liridona ishte kthyer kah muri dhe qante, nuk donte t'i shikonte prindërit, nuk donte të shikonte dhimbjen e tyre, frikohej se prindërit do të zbulojnë fshehtësinë e Gëzimit në sytë e saj, ajo dinte diçka, por nuk donte të tregonte, nuk donte t'u shtonte dhimbjen atyre.
Gëzimi u lirua nga duart e nënës dhe vrapoi në dhomën e tij, iku nga kjo bisedë e mundimshme për të, iku nga realiteti me të cilin duhej të ballafaqohej një ditë, por tani jo, ende nuk ishte i përgatitur.
- Gëzim! – thirri Bashkimi pas tij, por më kot, ai hyri në dhomën e tij duke mbyllur nga prapa derën.

Në dhomë ngelën prindërit dhe Liridona e kthyer me shpinë kah ata.
- Trego, moj ti, ti di diçka për të?! Përse nuk po tregon?! – iu drejtua Bashkimi bijës së tij.
- Trego, moj bijë! - e luti tani edhe nëna, e cila sikur tani parandiente, mundohej të paramendojë se ç'është ajo që po i ndodh Gëzimit, por si nënë nuk kishte guxim të thotë atë fjalë. I dukej se ajo fjalë do ta shponte thellë në zemër si me thikë, do ta shkatërrojë atë krejtësisht.
- Gëzimi përdor drogë! - tha Liridona duke u kthyer nga ata, e sytë i kishte të përlotur.
O Zot, fjala më e rëndë që kishte shqiptuar deri tani ajo në jetën e saj. Në këtë moment ajo do të kishte dashur që të gjendet diku larg, në ndonjë shkretëtirë, vetëm!
Donte vetëm të qante, të qante derisa të shfryhet, por ja; ajo ballafaqohet me realitetin, me të vërtetën, me fjalët më të hidhura për të.
- Si?! - pyetën gati njëzëri Bashkimi dhe Vjollca. Ata sikur nuk donin t'i besojnë veshëve të tyre, nuk donin të besonin fjalët që dëgjuan, nuk donin t'i pranonin ato fjalë.
Liridona nuk foli më fare, nuk mundej të përgjigjej nga lotët që po i rridhnin pa ndalë.
Bashkimi dhe Vjollca u ulën nëpër karrige, nuk mund të qëndronin më në këmbë, iu këputën këmbët nga ato fjalë që dëgjuan, për ta ky ishte një grusht i fortë.
Përveç problemeve ekzistenciale, largimi nga puna, ja tani edhe kjo me Gëzimin i tronditi pa masë Bashkimin dhe Vjollcën.
Ra zilja, në banese ishte vetëm Bashkimi, i cili ishte ulur në dhomën e ndenjes dhe shikonte

televizorin, dhe Vjollca, e cila punonte ne kuzhinë.
Bashkimit, edhe pse e dëgjonte zilen, i vinte mërzi të çohej dhe ta hapte derën.
Pasi zilja cingëroi një kohë të gjatë, Vjollca që e kishte dëgjuar doli nga kuzhina.
- Nuk e dëgjon zilen?! - i tha ajo Bashkimit, duke shkuar nga dera e hyrjes për ta hapur.
Bashkimi nuk foli, por vetëm e ngriti dorën lartë sikur donte të thoshte: "Punë e madhe! Le të jetë kush të jetë, unë nuk çohem ta hap derën".
- Mirëdita! – përshëndeti Ramizi kur Vjollca hapi derën.
- Mirëdita, urdhëroni! – e ftoi Vjollca.
Ramizi hyri brenda, me hapa shume të lehtë, që dukej sikur nuk shkelte fare në tokë, në dorë mbante celularin.
- Ku je, bre Bashkim, që moti nuk të kam parë! – tha ai gëzueshëm duke hyrë në dhomë.
- Ja ku jam, siç më sheh, në shtëpi! – u përgjigj Bashkimi me një zë jo të disponuar dhe mezi u ngrit nga karrigia dhe i zgjati dorën Ramizit.
Pasi u përshëndeten të dy u ulën nëpër karriget e tyre.
Ramizi la celularin në tavolinë dhe tha: - Bashkim ke humbur krejt, bre, çfarë po bën, ç'po punon?!
Pyetjen e bëri vetëm formalisht, sa për të filluar bisedën, sepse ai e dinte shumë mirë gjendjen e Bashkimit.
- Ja këtu në banesë, punoj diçka kur gjej punë! – u përgjigj Bashkimi.

- Pse nuk punon më atje në fabrikë? – pyeti përsëri Ramizi.
- Jo, jo, atje nuk ka më punë. – u përgjigj Bashkimi.
Në atë kohë Vjollca u solli kafet që kishte përgatitur.
- Po ty, Ramiz, si të shkon puna? - e pyeti Bashkimi, edhe pse e dinte se atij punët i shkojnë mirë, madje u pendua pse e pyeti, sepse e dinte që Ramizi kohët e fundit ishte bërë njeri që kishte shumë dëshirë të lavdërohet.
Ndaj edhe u pendua në këtë moment kur i parashtroi këtë pyetje të tepërt, nuk dinte se ç'të bënte, si do t'i duronte gjithë ato lëvdata të Ramizit.
- Mirë, faleminderit prej Zotit, puna është duke më shkuar mirë! - tha Ramizi dhe në atë moment, ndërsa fliste, i cingëroi celulari, dikush e kërkonte.
Mori celularin nga tavolina e hapi dhe bisedonte me dikë, ashtu lavdërueshëm saqë kjo po e nervozonte Bashkimin.
Sikur mos t'i vinte turp, ai në këtë moment do ta përzinte nga banesa.
- Dikush po më thërret, më falni se duhet të shkoj, biznesi nuk pret! – tha ai duke buzëqeshur dhe u nis kah dera.
- Kafenë, kafenë nuk e pive! – i tha Bashkimi dhe e zgjati dorën kah filxhani me kafe.
- Nuk kam kohë, njëherë tjetër, ditën e mirë! - tha ai dhe doli nga banesa.
Në atë moment Vjollca doli nga kuzhina dhe u habit kur pa Ramizin që po dilte nga banesa dhe Bashkimin që rrinte ulur, nuk ishte

ngritur ta përcillte. Ajo mendoi se mos vallë ka ndodhur diçka, apo mos vallë Bashkimi ka thënë diçka të papëlqyer.
- Pse shkoi ky, as kafenë se paska pirë! – tha Vjollca kur pa filxhanin plotë me kafe.
- Theu qafën, lëre pash Zotin! – tha Bashkimi.
- Po pse shkoi aq shpejt? – pyeti përsëri Vjollca.
- E thirri dikush në celular dhe shkoi – u përgjigj Bashkimi.
- Se si më duket Ramizi kohët e fundit ka ndryshuar shumë! – tha Vjollca.
- Me të nuk flitet, ai nuk shkel në tokë, ka para, prandaj edhe sillet në atë mënyrë! – tha Bashkimi.
- Paraja në dorë verbon të zotin! – tha Vjollca dhe, pasi mblodhi filxhanët, hyri në kuzhinë.
Bashkimi nuk shkonte më në punë, atë e kishin transferuar në entin për punësim si tepricë teknologjike. Këto ditë ishin të vështira për të, ishte mësuar të punojë, e tani ishte i detyruar të dalë çdo ditë në tregun e punës, por shumë rrallë gjente ndonjë punë.
Fati është me ty për një orë, kundër teje për dhjetë orë.
Krahaso dhimbjet e tua me të të tjerëve dhe do të duken më të vogla.
- Të lutem, zoti doktor, më trego si janë rezultatet? – iu drejtua Bashkimi mjekut.
Ai kishte ardhur në ambulancë, sepse kohët e fundit kishte dhimbje koke të mëdha, i thaheshin buzët dhe kishte etje të madhe.
Por në shtëpi ai nuk tregonte, ata as që e dinin se ky sot ka ardhur në ambulancë.

- Nuk e di se si t'ua them, nuk jeni shumë i sëmurë, por më duket se keni sëmundjen e sheqerit, sepse, sipas rezultateve që po shoh, sheqeri në gjak është rritur! – tha mjeku, i cili, ndërsa fliste, në dorë mbante letrat me rezultatet e gjakut dhe i shikonte me vëmendje.
- Sëmundjen e sheqerit!? – pyeti Bashkimi me gjysmë zëri vetëm sa të vërtetonte atë që dëgjoi.
- Po, ju keni diabetin, por mos u mërzisni se nuk është ndonjë sëmundje e rëndë, jetohet edhe me të, por vetëm se duhet dietë, më kupton? – i tha mjeku.
- Po, ju kuptoj! – u përgjigj Bashkimi me një zë të dëshpëruar.
Pas të gjitha atyre fatkeqësive tani edhe kjo, por çfarë të bësh kur të vijnë duhet t'u hapësh portën.
Pasi mjeku e këshilloi se si të mbajë dietë, çfarë nuk duhet ngrënë dhe çfarë nuk duhet pirë, ai u ngrit dhe doli nga ordinanca.
Ishte i rraskapitur, mezi ecte rrugës, në kokën e tij silleshin vërdallë shumë mendime.
Nuk i vërente fare njerëzit që kalonin përreth tij.
Ishte thelluar në mendime, çfarë të bëjë, t'i tregonte Vjollcës apo jo?
Pas një kohe të gjatë, pasi i analizoi mirë të gjitha mundësitë, vendosi të mos i tregojë asaj, ta kursejë atë nga dhimbjet e shumta që kishte përjetuar kohët e fundit.
Derisa Bashkimi dhe Vjollca atë pasdite rrinin ulur në dhomën e ndenjes dhe shikonin televizorin, nga jashtë u dëgjua një zhurmë,

një trokitje e fortë në derë, dikush i mëshonte derës me grusht.
Të dy u shtangën, shikonin njëri-tjetrin mos vallë gjenin përgjigjen e kësaj zhurme, kurse në kokat e tyre si në trakenë filmike kalonin ngjarje të ndryshme.
- Kush është, ç'po ndodh, shko shiko Vjollcë!? – e urdhëroi ai të shoqen.
- Nuk e di, të shoh! – tha Vjollca dhe me hapa të shpejtë u nis kah dera.
E hapi derën dhe ç'të shihte, korridori ishte mbushur plotë me policë.
- Mbylle derën! - i urdhëroi asaj një polic.
Ajo mbylli derën dhe me hapa të shpejtë u kthye në dhomë te Bashkimi, i cili ishte shndërruar i gjithi në veshë, priste se çfarë do t'i tregonte Vjollca.
- Hë, moj, kush ishte? – pyeti ai me padurim, nuk mund të priste që ajo të hynte në dhomë.
- Policia! – u përgjigj Vjollca.
- Si, moj, ç'ka ndodhur? – tha Bashkimi dhe brofi menjëherë në këmbë, u trishtua shumë. Mendja i shkonte në më të keqen, mendonte për fëmijët e tij, mos vallë ka ndodhur diçka me ta.
Si njeri që në jetë kishte përjetuar shumë gjëra të mira, por edhe të këqija, ishte bërë shumë i dijshëm, reagonte shpejtë, ishte bërë shumë emocional.
- Kanë hyrë te Ramizi, nuk e di përse! - tha Vjollca dhe u ul në karrige, nuk mund të rrinte në këmbë, i ishin këputur këmbët nga frika.
- Te Ramizi! E po ku ta dish se çfarë ka përzier ai! – tha Bashkimi me një lehtësim dhe u ul pranë tavolinës.

- Me të vërtetë ai kohët e fundit fitonte shumë para, si? – tha Vjollca.
- Gjithë ato para, me siguri ai ka punuar ndonjë punë të fëlliqur! – tha Bashkimi
- Po, po aty ka diçka të paligjshme, policia nuk vjen kot! - tha Vjollca.
Derisa këta rrinin në dhomë dhe bisedonin nga korridori dëgjoheshin zhurmat e policisë.
- Nëse ka punuar ndonjë punë të paligjshme, mirë t'i bëhet! – tha Bashkimi.
- Po, por po më dhimbset Kumrija, e ngrata nuk ka faj! - tha Vjollca, së cilës me të vërtetë i dhimbsej Kumrija, e shoqja e Ramizit, e cila me të vërtetë ishte një grua e urtë, e sinqertë.
Pas një kohe të gjatë u ndërprenë zhurmat, nga korridori nuk dëgjohej më asnjë zë.
- Do shkoj të shoh Kumrijen! – tha Vjollca dhe u ngrit nga karrigia.

Bashkimi nuk foli fare, por vetëm pohoi me kokë që donte të thoshte se ai pajtohej me vendimin e Vjollcës.
Bashkimi kishte ngelur vetëm në banesë, shikonte televizorin dhe mendonte diçka, ishte thelluar në mendime, mendonte për shëndetin e tij, çfarë do të ndodhte, si do ta ruante këtë fshehtësi prej Vjollcës.
E shikonte jetën e tij në një labirint të çuditshëm, pa zgjidhje, çdo herë që i afrohej daljes nga ai labirint, përpara i dilte diçka e papritur dhe e ndiente veten si një njeri të humbur.

Vjollca u kthye menjëherë, nuk ndenji gjatë te Kumrija saqë kjo e befasoi Bashkimin, i cili u habit kur pa se Vjollca u kthye.
- Sa keq ! - tha Vjollca, ende pa hyrë mirë brenda.
- Hë, moj, ç'ka, pse u ktheve menjëherë? – pyeti Bashkimi.
- Ramizin e kishin arrestuar! – u përgjigj Vjollca.
- Përse? – pyeti Bashkimi me një zë shumë të qetë, sikur ai ta kishte ditur se do ta arrestonin dhe ja, tani kur kuptoi se e kanë arrestuar, e pranoi si një lajm krejt normal, si një gjë e pritur.
- Për drogë, i paskan gjetur drogë në banesë! – u përgjigj Vjollca.
- Për drogë!? – tha Bashkimi i habitur dhe përnjëherë u kthye nga Vjollca, atij tani menjëherë i shkoi mendja te Gëzimi, djali i tij, të cilit dikush i jepte drogë.
- Po, për drogë! – u përgjigj Vjollca.
- Mirë ja kanë bërë, qenit! – tha ai dhe me grusht i mëshoi tavolinës.
- Mos bërtit se po të dëgjon Kumrija, është marrëzi! – tha Vjollca.
- Le të dëgjojë, nuk është marrëzi, njerëz të tillë duhen burgosur se marrin në qafë shumë të rinj! - tha Bashkimi, i cili, derisa fliste, nuk mund të rrinte i qetë, ishte nervozuar shumë, prandaj shëtiste nëpër dhomë.
- Po, por Kumrija nuk ka faj! – i tha Vjollca.
- Si nuk paska faj?! Prej sot nuk dua më të shkosh te ata dhe as që dua të më vijnë, a kuptove!? – i tha ai Vjollcës me një zë të lartë dhe qortues, e gjithë kohën, ndërsa fliste, ai

bënte me gisht si prindërit kur qortojnë fëmijët që të rrinë urtë.
Pas kësaj Vjollca nuk foli më fare, pasi e shihte se çdo fjalë do të jetë e tepërt, se Bashkimi ato fjalë i tha me shumë nervozizëm.
Bashkimi doli nga shtëpia i nervozuar dhe me siguri do të shëtiste pak derisa t'i kalonte ai mllef.
Ditët kalonin dhe afrohej festa e Vitit të Ri, dimri ishte shumë i ftohtë, çdo ditë binte borë.

Bashkimi gjithë ditën e kalonte brenda në banesë. Mentori shkonte në fakultet, Liridona në shkollë, ajo ishte maturante, ndërsa Gëzimi kishte dy muaj që ishte shtrirë në spital.
E kishin dërguar të shërohet nga vartësia e narkotikëve.
- Gëzimi ishte shume keq! - tha Vjollca e përlotur, kishte qarë shumë, sepse ajo sot kishte vizituar Gëzimin në spital.
- Nuk ishte hiç më mirë? – pyeti Bashkimi vetëm sa për të vazhduar bisedën, sepse edhe ai e shihte nga fytyra e së shoqes se atë që ajo tha ishte shumë e vërtetë.
- Jo, nuk kishte përmirësim! – u përgjigj Vjollca me një zë pak më të qetësuar.
Pas kësaj, për një kohë të gjatë të dy nuk folën fare, në dhomë mbretëroi një qetësi, një qetësi që ishte shumë e nevojshme për shpirtrat e këtyre dy bashkëshortëve që, si duket, fati u kishte kthyer shpinën.

Diku në mbrëmje erdhën Mentori dhe Liridona.
- Liridona, mbushi filxhanët me çaj! - e urdhëroi ajo të bijën e saj.
- Unë nuk dua, mos më mbush. - tha Bashkimi, i cili gjithë kohën shikonte televizorin.
- Pse nuk pi ti kohët e fundit çaj, ti e ke pasur shumë qejf!? – e pyeti Vjollca e habitur, pasi Bashkimi nuk donte të pinte çaj, ajo filloi të dyshojë tek ai, se diçka po ndodhte me të.
- Jo, jo, nuk më pihet! – u përgjigj Bashkimi pa e larguar fare shikimin nga televizori.
Edhe Mentori me Liridonën çuditeshin se përse babai i tyre kohët e fundit nuk po pinte çaj, nuk i ha ëmbëlsirat, në kokat e tyre silleshin shumë mendime, por kurrsesi nuk ishin afër së vërtetës, sepse ata mendonin se ai vepronte ashtu për të kursyer, nuk është në punë dhe prandaj nuk do të harxhojë, ose, më mirë të themi, mundohet të mësohet pa to.
Bashkimi ishte me të vërtetë në pozitë të vështirë. Ai, përveç asaj që e mundonte sëmundja, duhej të kujdesej se çfarë do të hante dhe do të pinte, do të thotë se duhet të mbante dietë, e, në anën tjetër, këtë të mos e hetojnë anëtarët e familjes. E kishte me të vërtetë shumë të vështirë.

Ishte 31 dhjetor. Vjollca që në mëngjes ishte duke përgatitur diçka në kuzhinë, ndërsa

Bashkimi ishte ulur në dhomën e ndenjes dhe shikonte televizorin si zakonisht.
- Mirëmëngjesi, babi! – e përshëndeti Liridona, e cila dilte nga dhoma e saj.
- Mirëmëngjesi! – ia ktheu përshëndetjen Bashkimi pa e larguar fare shikimin nga televizori.
- Urdhëro kafenë! – i tha Vjollca, e cila kishte përgatitur dy kafe dhe u ul në tavolinë pranë tij.
Bashkimi nuk foli fare, ishte thelluar në mendime, si duket diçka e rëndonte kokën e tij, problemet grumbulloheshin njëri pas tjetrit e zgjidhje nuk mundej të gjente assesi, për një kohë të shkurtër i ndodhën shumë gjëra.
- Si nuk u zgjuan këta! – tha Vjollca vetëm sa për të prishur atë monotoni të mërzitshme, për të filluar bisedën.
- Liridona është në banjë - tha Bashkimi, i cili më në fund i largoi nga koka e tij mendimet nga të cilat dukej sikur do t'i pëlciste koka po të vazhdonte edhe pak në atë gjendje.
- Qenka zgjuar, a!? – tha Vjollca e gëzuar që ai e përkrahu bisedën e saj, dhe pastaj vazhdoi: - Mentori ende nuk është zgjuar, po shkoj ta zgjoj të hamë mëngjesin, se kam shumë punë! – tha ajo duke u ngritur nga tavolina dhe shkoi në dhomën e Mentorit.
Pas një kohe të gjithë ishin ulur pranë tavolinës dhe hanin mëngjesin.
Të gjithë… jo, nuk ishin të gjithë, mungonte Gëzimi. Ai ende ishte në spital dhe ditëve të fundit gjendja e tij ishte përmirësuar pak.

Jashtë binte një borë e lehtë saqë fjollat e borës ngjiteshin në xhamat e dritares së kuzhinës, por nuk ishte dhe aq shumë ftohtë.
Në kuzhinë mbretëronte një atmosferë e ngrohtë familjare, në fytyrat e të gjithëve vërehej njëfarë gëzimi, është dita e Vitit të Ri, po sonte ata të gjithë së bashku kanë për të festuar këtë festë.
- Sot do të vijë Gëzimi! – tha Vjollca e lumtur, sytë i shkëlqenin nga gëzimi, nënë e shkretë që sa vite festën nuk e kishte bërë së bashku me fëmijët e saj, apo, më mirë të themi, se ata me vite të tëra nuk kishin festuar asnjë festë bashkë.
Fëmijët me shokët dhe shoqet e tyre, burri diku me kolegët e tij të fabrikës.
Kurse sivjet kushedi se pas sa viteve ata të gjithë do të jenë sërish bashkë.
- Kush të tha që do të vijë edhe Gëzimi, nënë? – pyeti Liridona e habitur dhe njëkohësisht asaj në fytyrë i vërehej lumturia.
Dukej sikur në këtë ditë nuk ka njeri më të lumtur se ajo.
Edhe Bashkimi me Mentorin e vështronin me habi, edhe ata nuk dinin gjë për ardhjen e Gëzimit.
- Po, do të vijë, dje kur isha në spital bisedova me mjekun kryesorë. Ai më tha se Gëzimi mund të vijë dy ditë në shtëpi, sepse është më mirë! - tha Vjollca e gëzuar dhe mori filxhanin për të pirë kafenë.
Ky lajm i gëzoi të gjithë, më në fund të gjithë do të jenë bashkë, do të festojnë së bashku.
Pas ngrënies së mëngjesit secili kishte shkuar ne drejtimin e vet për të kryer detyrat,

obligimet e tyre, kurse Vjollca, detyra e saj dihet, ajo është kuzhina.
Ajo përgatiste diçka atje dhe gjithë kohën nga kuzhina dëgjohej kënga e saj.
Ndërsa bënte ndonjë punë ajo këndonte, më mirë të themi ajo fluturonte nga njëri skaj i kuzhinës në tjetrin, e në kokë gjithnjë kishte tavolinën festive, me të gjithë përreth, për herë të parë nuk do të mungonte askush.
- Zot, shyqyr! – thoshte ajo me vete në kuzhinë.

Gëzimi kishte hapur derën e hyrjes, askush nuk ishte në dhomën e ndenjes, vështroi rreth e përqark, por nuk pa njeri, eci edhe pak dhe m'u në mes të dhomës u ndal, dëgjoi zërin e nënës që vinte nga kuzhina, dëgjoi një moment dhe pastaj me dorë rregulloi flokët që i ishin lagur nga bora që binte jashtë dhe u nis drejt kuzhinës.
- Këndon shumë bukur, nënë! – tha ai nga dera e kuzhinës.
Nëna kur dëgjoi se dikush i foli nga prapa ndërpreu këngën, e frikësuar u kthye kah dera përnjëherë.
- Gëzim, bir i nënës, erdhe! – tha ajo duke vrapuar drejt tij dhe e përqafoi.
Qëndruan të dy të përqafuar për një kohë të gjatë, nuk mundeshin të ndaheshin sikur nuk ishin parë për një kohë të gjatë, edhe pse nëna dje e kishte vizituar në spital.

Por kjo ishte me të vërtete një situatë krejt tjetër, pas një kohe të gjatë Gëzimi ishte përsëri në shtëpi.
- Hë, nënë, mendove se do të vdes, se nuk do të vij më kurrë në shtëpi? – tha Gëzimi duke qeshur.
- Jo, bir, larg qoftë! – tha nëna me sy të përlotur, por jo nga pikëllimi, tani kjo loke qante nga gëzimi.
Më vonë në shtëpi u kthyen edhe Mentori me Liridonën, të cilët u përshëndeten me shumë mall me vëllanë e tyre të vogël.
Më në fund u kthye edhe Bashkimi, i cili vetëm e përshëndeti ftohtë Gëzimin, ai nuk mund t'i falte lehtë atij që përdorte drogën, ja edhe tani ai vetëm e përshëndeti e në fytyrë dukej sikur nuk gëzohej aspak që ai ishte përsëri në shtëpi.
Por edhe ai në shpirtin e tij të plagosur kishte një ndjenjë gëzimi, edhe pse nuk e shprehte atë, ai kurrsesi nuk mund t'i falte Gëzimit atë gabim që kishte bërë.
Për hir të atmosferës festive, ai ishte përmbajtur që sot të mos e qortojë Gëzimin, edhe pse kishte shumë dëshirë ta qortojë.
Vetëm shpirti i tij i vuajtur e dinte se çfarë ndjente, zemra e tij e lodhur e dinte më mirë atë, por ja ai përmbahej.

Atë mbrëmje të gjithë ishin të lumtur e sidomos nëna, e cila gjatë gjithë kohës herë shikonte njërin e herë tjetrin dhe kënaqej,

shpirti i mbushej me kënaqësi dhe vetëm buzëqeshte.
Ishin ulur përreth tavolinës në të cilën kishin vendosur diçka për të ngrënë.
Por tavolina nuk ishte e mbushur si viteve të tjera, tani ajo ishte më e varfër, nuk ishte më e mbushur plotë.
Shikonin televizorin i cili për festë kishte muzikë të zgjedhur dhe herë pas here rrihnin shuplakat dhe këndonin.
Bashkimi gjithë kohës rrinte indiferent, mundohej që herë pas here të jepte shenjë se është prezent, por, në të vërtetë, ai me mendjen e tij udhëtonte nëpër rrugët e qytetit, më mirë të themi bridhte rrugëve të qytetit dhe çdo herë haste në ndonjë rrugë qorre, pa dalje.
Papunësia, sëmundja e tij, Gëzimi narkoman, të gjitha këto e mundonin Bashkimin, gjithë mbrëmjen i silleshin vërdallë nëpër kokë.
Por, edhe për skaj të gjitha këtyre, ai bëhej sikur nuk kishte asgjë, sikur çdo gjë ishte në rregull me të, për këtë edhe ai rrihte shuplakat, por nuk këndonte.
Kur po afrohej mëngjesi, ai nuk mundi të duronte më, pasi piu një kokërr për kokën, sepse i kishte filluar t'i dhembte, u kthye kah Gëzimi.
- Si kalon atje në spital? – e pyeti ai.
- Mirë, mirë! – u përgjigj Gëzimi dhe uli kokën.
Uli kokën ashtu siç e ul një njeri që ka bërë ndonjë gabim, njeri që e ndjen veten fajtor.
- A ka gjasa të shërohesh? – pyeti ai përsëri.
- Nuk e di! – u përgjigj Gëzimi, pa e ngritur kokën fare.

- Si nuk e di, ti patjetër duhet ta lësh drogën se përndryshe nuk ke shpëtim! – i tha Bashkimi me një zë pak më të lartë dhe nervoz.
- Ej, ç'po ndodh me ju të dy? – ndërhyri Vjollca, kur pa se situata po acarohej.
- Punë për mua! – tha Gëzimi dhe me rrëmbim u ngrit nga tavolina dhe vrapoi e shkoi drejt e në dhomë.
- Shko në dreq të mallkuar! – bërtiti pas tij Bashkimi dhe i mëshoi me grusht tavolinës.
E pa i ngrati se sa është ora, nuk ka shpëtim për këtë, mendoi ai, ky do të vazhdojë edhe më tej me drogë.
- Mos, bre burrë, mos fol ashtu! – tha Vjollca e trishtuar dhe u ngrit në këmbë.
- Ngadalë, mos u ngut, lëre rehat djalin, a nuk e sheh se ka filluar të përmirësohet! – i tha ajo Bashkimit.
- E shoh unë përmirësimin e tij! – tha Bashkimi me plot ironi dhe pastaj, pasi bëri një pauzë të shkurtër, vazhdoi: - A e dëgjove se çfarë tha, nuk e di! Do të thotë se ai nuk ka dëshirë të largohet nga droga. Ai do të vazhdojë ta përdorë atë deri në vdekje! – tha Bashkimi dhe u drodh pakëz, sikur iu rrëqeth trupi nga fjala e fundit që tha. Ai u shkund njëherë dhe shkoi në dhomën e fjetjes.
Pas tij u ngritën edhe Mentori me Liridonën, të cilët, gjithashtu, shkuan të flenë.
Vetëm Vjollca kishte ngelur në dhomën e ndenjes, ishte ulur pranë tavolinës dhe përsëri qante.
Qante, por qante pa zë, që të mos e dëgjonte ndokush.

Për një çast u zhduk ai gëzim i mbrëmjes, mbretëroi qetësia, nëpër faqet e nënës rrokulliseshin lotët pa ndalë, shumë e shkurtër ishte koha e lumturisë së kësaj nënë.
Ilaçi më i mirë për kohët e fatkeqësisë është durimi.
Gëzimi, edhe pse mjeku i kishte dhënë dy ditë leje për pushim, të nesërmen u kthye në spital.

Ishte dimër i fortë me shumë borë, por për fat Bashkimi gjente ndonjë punë pasi ai ishte elektro-inxhinier, e thërrisnin të rregullonte ndonjë prishje të rrymës, të aparateve të ndryshme, kështu që kishte punë.
Ditët kalonin gati të njëjta, identike pa ndonjë ndryshim në jetën e kësaj familje, çdo gjë ishte si më parë, me të njëjtat probleme.
Mentori i kishte dhënë me sukses provimet që i kishte për atë vit në fakultet .
Liridona tanimë ishte në gjysmë vjetorin e fundit të shkollimit të mesëm, vetëm Gëzimi nuk ishte mirë.
Prej ditës së 1 janarit kur ishte kthyer në spital, atë e vizitonte vetëm nëna, gjendja e tij nuk ishte përmirësuar fare.
Përkundrazi, ai edhe më tej merrte drogë.
Nëna, edhe punonte në kuzhinë, edhe qante, por qante pa zë, në heshtje dhe lotët i rridhnin pa ndalë nëpër faqe.
- Nënë, ti po qan! – i tha Liridona një ditë kur u kthye nga shkolla.

- Jo, bijë, lotët më rrjedhin vetë! – u përgjigj nëna.
- Pse nënë? – e pyeti Liridona më kot, sepse edhe ajo e dinte shkakun e atyre lotëve.
- Vëllanë nuk e ke fare mirë! – u përgjigj nëna dhe fshiu me dorë lotët që i rrokulliseshin nëpër faqe.
- Gëzimi?! – pyeti formalisht Liridona, sepse edhe ajo e dinte, e kishte të qartë se nëna fliste për të.
Nëna nuk foli fare, por vetëm pohoi me kokë për ta miratuar.
Pas kësaj, të dyja nuk folën më asnjë fjalë, si duket fjalët ishin të tepërta.
Po afrohej pranvera, Bashkimi e ruante ende fshehtësinë për sëmundjen e tij, akoma nuk kishte kuptuar ndokush për gjendjen e tij shëndetësore.
Ai shkonte te mjeku rregullisht dhe i përmbahej dietës që ai i kishte rekomanduar.
Kohët e fundit Vjollca dyshonte për diçka, por nuk kishte guxim ta pyeste. Ajo dyshonte kur shihte se nuk pinte çajin si më parë, largohej prej ëmbëlsirave, por nuk kishte guxim, jo nuk guxonte ta pyeste.
E shihte edhe ajo që i ngrati tretet në vete, ka shumë probleme, prandaj nuk e pyeste fare për këtë dyshim.
Ishte pranverë, koha kishte filluar të nxehet, kështu që edhe në banesë rrallë mblidheshin të gjithë anëtarët e familjes.
Nuk kishte më ngrohtësi familjare, shumë rrallë uleshin bashkë në tavolinë, secili pas punëve të veta.

Ishte ditë e zakonshme pranverore, Bashkimi punonte diku në qytet.
Mentori dhe Liridona secili pas obligimeve te veta, vetëm Vjollca kishte ngelur në banesë.
Ajo si zakonisht kryente punët e saj të përditshme.
Derisa në banesë mbretëronte një qetësi absolute ra zilja, dikush ishte te dera.
A thua kush mundet të jetë, mendime të shumta filluan t'i sillen asaj nëpër kokë.
E hapi derën me vrull dhe u shtang kur përpara saj pa postierin.
Ç'kërkon ky, mendoi! Mos vallë ka sjellë ndonjë urim të vonuar për Vitin e Ri, mos vallë…, mos vallë…, mendonte ajo.
- Urdhëroni! – i tha ajo postierit, i cili rrinte me një letër në dorë para derës.
- Është Bashkimi aty? – pyeti postieri me një ton brengosës.
- Jo! – u përgjigj shkurt Vjollca dhe gjatë gjithë kësaj kohe shikimin e kishte të pa përcaktuar, shikonte postierin, por në të vërtetë ajo atë nuk e shihte mirë, sepse i ishte turbulluar shikimi.
- Një telegram për të. – tha postieri, dhe i zgjati letrën që mbante në dorë.
Nëna e mori letrën dhe nuk e përshëndeti fare postierin, u kthye brenda e mbylli derën dhe shpejtoi të hapte telegramin, të shihte se çfarë shkruhej në të.
- O Zot, jo! – bërtiti ajo kur lexoi telegramin.
Në telegram thuhej për atë që Bashkimi e kishte parashikuar shumë më parë dhe që kishte thënë se do të ndodhte një ditë.

Ishte telegram nga spitali ku mjekohej Gëzimi. Në të thuhej se Gëzimi ishte në gjendje kritike për shkak të përdorimit të drogës dhe dozave të mëdha të saj.
Në të vërtetë në telegram shkruhej: "Biri juaj është në gjendje kritike! Ju lutemi, ejani sa më shpejtë."
Nëna e flaku letrën në tokë dhe duke vrapuar doli nga banesa, u nis për në spital, sepse sekondat ishin në pyetje.
Donte ta gjente të gjallë djalin e saj, për të fundit herë të dëgjonte një fjalë prej tij.

Rrugës gjatë gjithë kohës ajo qante, kështu që njerëzit që e shihnin habiteshin me të, por edhe ata mundoheshin të paramendojnë se përse qan një grua, një nënë. Ata e kishin të qartë deri diku se asaj i ka ndodhur diçka, e kishin të qartë se një loke nuk qan kot.
Arriti në spital, duke vrapuar u ngjit në katin e dytë ku ishte i shtrirë Gëzimi.
Hyri në dhomë, pranë krevatit ishin disa mjekë dhe infermiere, të cilat mundoheshin ta ndihmojnë.
Kur e panë nënën që hyri në dhomë, ata u larguan, i bën vend të afrohej pranë birit të saj, i cili po jetonte sekondat e fundit.
Nëna u afrua dhe e kapi për njërën dorë.
- Pse, bir? – tha shkurt, sepse nuk mund të fliste më tepër.
- Babai, nën, babai kishte të drejtë! – tha Gëzimi dhe mbylli sytë përgjithmonë.

Nga zemra e nënës u këput një pjesë përgjithmonë.
Si një gurë kur rrokulliset prej shkëmbit të lartë dhe bëhet copë e thërrime, ashtu edhe nëna e shkretë në shpirtin e saj ndjeu një dhimbje të fortë.
Në atë çast ndjeu një zbrazëti të pafund, e ndjente veten si në një humnerë të errët.
O Zot, Gëzimi i saj nuk do të jetë më, ai shkoi në botën tjetër, zemra i shtrëngohej saqë donte t'i pëlciste, t'i dilte nga gjoksi.
Infermieret e kapen për krahu dhe e larguan më tej duke u munduar që ta qetësonin, t'i jepnin kurajë.
Bashkimi ishte kthyer me herët nga puna, nuk kishte pasur shumë punë, vetëm se të rregullonte një defekt të thjeshtë të rrjetit elektrik në një shtëpi në qytet.
Sikur të ishte porositur, sot u kthye më herët se zakonisht.
Hapi derën e banesës dhe dëgjonte se mos vallë kishte ndonjë zë, por nuk dëgjohej asgjë, sepse nuk në banesë nuk kishte njeri.
Hyri në dhomën e ndenjes plot kureshtje, nuk dëgjonte asnjë zhurmë. Ai e dinte se e shoqja duhej të ishte diku aty duke kryer punët e saj të përditshme.
Vështroi rreth e përqark, dëgjoi mirë, por asnjë zhurmë nuk arriti të dëgjonte dhe atëherë sytë i shkuan te letra e hedhur në tokë.
Te ajo copë letër që u solli lajmin më të dhimbshëm.

U ul, e mori letrën, buzët i ishin tharë pak nga diabeti dhe pak nga frika. Çfarë ka ndodhur me të shoqen, ku është, e shumë pyetje të tjera e mundonin në këtë çast.
E lexoi letrën, e pastaj e shtypi në njërën dorë, të cilën e kishte shtrënguar aq shumë sikur donte ta shtrydhte, të fshinte atë që shkruhej në të.
Lotët filluan t'i rridhnin, nuk mund të përmbahej.
- Jo, jo! – bërtiti dhe përplasi letrën për murit të dhomës dhe vrapoi e doli nga banesa, tanimë e kishte të qartë se ku ndodhej Vjollca.
Jeta e njeriut është e tillë, ajo përbëhet nga shumë gjëra të mira dhe të këqija, por për Bashkimin si duket ajo përmbante më shumë të këqija.
Me ndihmën e veturës së spitalit e sollën trupin e pajetë të Gëzimit në banesë.
Më vonë në shtëpi ishin kthyer edhe Mentori me Liridonën, të cilët ishin tronditur shumë për vdekjen e vëllait të tyre të vogël.
Dita ishte e nxehtë, nuk i përngjante një dite të rëndomtë pranverore, natyra zbardhej nga lulet e pemëve të çelura.
Gjithçka ngjallej, vetëm se një jetë ishte shuar, një i ri largohej përgjithmonë nga kjo botë.
Pas përgatitjeve që kishin bërë në banesë, ata u nisën për në varrezat e qytetit për të varrosur këtë të ri.
Të gjithë i kishin sytë të përlotur, burra, gra, fëmijë, të gjithëve u vinte keq dhe prandaj qanin.

Më vonë kur u kthyen nga varrezat të gjithë shkuan nëpër shtëpitë e tyre.
Në dhomën e ndenjes pranë tavolinës ishin ulur Bashkimi, Vjollca dhe dy fëmijët e tyre dhe gjyshja që kishte ardhur menjëherë nga fshati kur kishte marrë vesh lajmin e hidhur.
Po, ishin ulur të gjithë, por vetëm një karrige ishte e zbrazët, aty nuk do të ulet më ai, e me siguri të gjithë këta do të donin që ai përsëri të ulej aty, por ja ai nuk është më në mesin e tyre.
- Doni të hani diçka? – pyeti Vjollca duke fshirë lotët.
Asnjëri prej tyre nuk foli, të gjithë fshinin lotët.
Me siguri nuk kishin oreks, nuk i hahej askujt, por nuk folën me qëllim që të lënë hapësirë për tjetrin nëse ka dëshirë të hajë diçka se ndoshta dikujt i hahej, mendonin ata.
Nëna u ngrit dhe hyri në kuzhinë të përgatiste diçka për të ngrënë, edhe pse dhimbja e saj ishte e madhe, nuk kishte vullnet të punonte diçka, por prapëseprapë ajo duhej të mendonte edhe për dy fëmijët e tjerë, për hir të tyre ajo u ngrit të përgatiste diçka.

Mandej i vinte keq edhe për nënën e saj plakë, e dinte se nuk kishte futur asgjë në gojë që kur kishte ardhur nga fshati.
Pas një kohe, ajo përsëri hyri në dhomë dhe i ftoi të gjithë të hynin në kuzhinë për të ngrënë diçka.

- Ejani, ngrihuni të hamë diçka! – i luti ajo të gjithë.
Të gjithë u ngritën, edhe pse nuk kishin vullnet për të ngrënë, u ngritën vetëm për të mos prishur rendin, fshinë lotët dhe hynë në kuzhinë.
Më vonë në banesë kishin ardhur disa burra dhe gra që t'u shprehin ngushëllimet.
Krahaso dhimbjet e tua me të të tjerëve e do të duken më të vogla.
Ditët kalonin gati të njëjta, asgjë nuk ndodhte, asgjë nuk ishte më si më parë, të gjithë anëtarët e familjes ndjenin në shpirtin e tyre një zbrazëti, u mungonte ai që e kishin dashur shumë.
Bashkimi nuk ishte më i njëjti, ishte dobësuar shumë, saqë në fytyrën e tij vëreheshin më se tepërmi mustaqet e zeza, sytë i ishin thelluar në gropëzat dhe buzët i kishte gjithmonë të thara, kohët e fundit kishin filluar t'i krisen shumë.
Pasiguria sociale, papunësia, vdekja e djalit dhe sëmundja e sheqerit e kishin lodhur krejtësisht.
- Po dal pak në qytet! – tha ai vetëm sa për të filluar bisedën, edhe pse këtë nuk e thoshte që t'i tregojë Vjollcës se do të dilte në qytet, sepse ai asnjëherë nuk i tregonte asaj se ku do të shkonte.
- Shko, por nuk më dukesh mirë! – tha Vjollca, e cila vërente se në çfarë gjendje ishte dhe donte t'i thoshte se ai nuk mundej të punonte në një gjendje të tillë, nuk ishte i aftë.
- Jo, nuk do të punoj sot, vetëm… - deshi të thotë edhe diçka, por e ndërpreu rrëfimin,

sepse iu duk se nuk ishte momenti për të treguar. Ai nuk tregoi asgjë dhe vetëm bëri me dorë sikur donte të thoshte: Asgjë, asgjë.
- Ku do të shkosh? – e pyeti përsëri Vjollca, e cila tanimë ishte bërë kureshtare, sepse nga sytë e Bashkimit vërente se ai kishte një fshehtësi, se ai donte t'i tregonte diçka, por nuk dinte se si.
- Po dal të shëtis pak – tha Bashkimi dhe me shpejtësi doli nga banesa që Vjollca të mos i parashtronte më pyetje, sepse, nëse vazhdonte me pyetjet, ai frikohej se nuk do të dinte çfarë përgjigje t'i jepte, se mos vallë ajo do ta hetonte se ky fshihte diçka.
Vjollca ngeli vetëm në dhomë, ajo filloi të mendojë rreth asaj se çfarë po ndodhte me Bashkimin.

Për herë të parë, pas shumë peripecive që kishte përjetuar, pas një kohe goxha të gjatë, ajo mendonte vetëm për të.
Ç'po ndodhte me të kohët e fundit, ishte bërë shumë misterioz, diçka fshihte.
Në kokën e saj tani silleshin të gjitha gjërat në lidhje me Bashkimin, mos pirja e çajit, refuzimi i ëmbëlsirave, mbajtja e njëfarë diete që nuk ishte karakteristike për të.
Pastaj, dalja e tij në qytet edhe kur nuk kishte punë, gjendja e tij fizike dhe psikike, të gjitha këto silleshin vërdallë në kokën e saj të lodhur.

- O Zot, jo! – klithi ajo dhimbshëm dhe pas një kohe të gjatë vendosi që kur ai të kthehet të bisedojë me të më gjatë, të mësojë se çfarë fsheh në shpirtin e tij të lodhur.
Pas atyre që kishte menduar ajo kishte ardhur në përfundim se ai me të vërtetë fsheh diçka dhe se patjetër duhet t'i sqarojnë gjërat.
Mentori dhe Liridona ishin në qytet.
Mentori ishte në bibliotekën e qytetit ku përgatiste provimet për afatin e qershorit, kurse Liridona ishte në shkollë. Ajo për pak kohë do të kryente shkollën e mesme dhe do të festonte mbrëmjen e maturës.

Bashkimit në laborator i kishin marrë gjak dhe tani priste të merrte rezultatet.
Pasi mori rezultatet, ai shkoi në ordinancë te mjeku i tij, hyri brenda dhe, pasi e përshëndeti, u ul në karrigen që kishte përpara.
- Doktor, si janë rezultatet? – pyeti mjekun, i cili kishte marrë letrën e rezultateve dhe i vështronte.
Mjeku e shikonte letrën, kurse në fytyrë i vërehej njëfarë brengosje. Ai nuk foli për një kohë të gjatë.
- Bashkim, nuk më duket rezultat i mirë! – ia ktheu mjeku.
- Nuk është mirë, a?! – pyeti Bashkimi, vetëm sa për të vërtetuar atë që tha mjeku.
Mjeku nuk foli fare, por vetëm pohoi me kokë.

- Çfarë mund të bëjmë? – pyeti Bashkimi me plot kureshtje.
- Tani patjetër duhet të marrësh injeksione insuline, që të normalizohet sheqeri në gjak! – tha mjeku me një zë të qetësuar dhe pastaj vazhdoi si për t'i dhënë kurajo: - Mos u brengos se nuk është edhe aq keq. Me injeksione do të rregullohet sheqeri dhe çdo gjë do të jetë në rregull.
Pastaj Bashkimi u çua dhe, pasi u përshëndet me mjekun, doli nga ordinanca.
Rrugës për në shtëpi ai mendonte se si t'i tregonte Vjollcës.

Ishte thelluar në mendime saqë nuk i vërente njerëzit që kalonin përreth tij.
Ata e përshëndesnin, ndërsa ky aspak nuk i hetonte, sepse në mendjen e tij gjendej në banese dhe bisedonte me Vjollcën.
Me të vërtetë ishte në pozitë të rëndë, si të vepronte, t'i tregonte, por si?
Do ta lëndonte atë pas asaj që kishte përjetuar me vdekjen e djalit, shpirti i saj ishte i lodhur, e ky lajm do ta këpuste atë krejtësisht.
- Jo, jo! – murmuriste me vete dhe vendosi që për një kohë të mos i tregonte, të ruaj edhe pak vetëm për vete këtë fshehtësi, le të ngelet kjo edhe për një kohë vetëm sekreti i tij.
Ishte pasdite. Pasi kishin ngrënë drekën, të gjithë ishin ulur në dhomën e ndenjes.
- Bashkim, dua të të pyes për diçka! – tha Vjollca dhe e shikoi drejt e në sy.

- Çfarë ke, pyet! – tha Bashkimi dhe uli kokën për t'i ikur shikimit të saj, sepse nga sytë e tij ajo do të hetonte sekretin e tij.
- Bashkim, mos je i sëmurë? - e pyeti ajo në mënyrë direkt, saqë i habiti Mentorin dhe Liridonën, të cilët, kur dëgjuan këtë pyetje, shikimin e drejtuan kah babai i tyre.
Edhe ata tani pyeteshin se mos valle me të vërtetë ai është i sëmurë.
- Po! - u përgjigj shkurt Bashkimi. Ai e shihte se nuk mund të fshinte më asgjë. Vjollca i kishte menduar mirë të gjitha gjërat gjatë këtyre kohëve dhe se ajo ishte e sigurt në pyetjen që i bëri.
- Çfarë të dhemb, pse nuk ke treguar? – e pyeti ajo me një zë qortues.
- Nuk më dhemb asgjë, kam sheqerin! – u përgjigj ai me një zë të qëndrueshëm. Tani kishte ngritur kokën, nuk donte që para së shoqes dhe fëmijëve të dalë se është i dobët, se frikohet.
- Prej kur? – pyeti përsëri Vjollca.
- Po ka disa muaj! – u përgjigj Bashkimi me një zë të sigurt sikur donte të thoshte se për të nuk është asgjë.
- Dhe ti nuk ke treguar?! – e qortoi përsëri ajo.
- Çfarë të tregoj, nuk është asgjë, mirë jam! – tha Bashkimi.
- Babi, është dashur të tregosh! - e qortoi edhe Mentori.
Kurse Liridona, e cila kishte ndër mend t'u tregonte atyre për mbrëmjen e maturës, të bisedonte me të dashurit e saj për mbrëmjen më të gëzueshme të jetës së saj, kur dëgjoi për

sëmundjen e babait nuk kishte vullnet më të fliste pasi sytë iu mbushën me lot.
U ngrit nga vendi ku ishte ulur dhe shkoi në dhomën e saj.
Në dhomë ajo kishte qarë një kohë të gjatë, kishte qarë për Gëzimin, për të atin, për të gjitha.
Asaj tani vetëm gjëra të këqija i silleshin nëpër kokë.
Njeriu i humbur në labirintin që quhet jetë.
Sado që njeriu të mendojë se është i lumtur, nuk dihet se çfarë sjell çasti që vijon, për një moment mundet të ndryshojnë gjërat.
A ka kuptim jeta pa probleme, kuptohet që jo. Zgjidhja e problemeve, brengave, atë e bëjnë më dinamike.
Njeriu jeton se ka një qëllim në jetë, ka një cak që do ta arrijë. Pse duhet të jetonte nëse nuk do të kishte një qëllim për të arrirë? Cili do të ishte qëllimi i jetesës së tij? A do të kishte ai ndonjë cak që do të donte ta arrinte?
Njeri i humbur, por çdo herë në skaj të tunelit ka një fije drite, e cila të jep shpresë për jetë.

Mbas lumturisë dhimbja, e mbas dhimbjes lumturia.
Bashkimi kthehej në shtëpi i lumtur, pas një kohe të gjatë u kthye gëzimi në shpirtin e tij, rrugës ai gati sa nuk fluturonte.
Ky gëzim vinte sepse ai kishte gjetur punë në një sipërmarrje private që merrej me ndërtimin e shtëpive.

Si elektro-inxhinier ai do të instalonte rrymën në shtëpitë e reja që ndërtoheshin.
Por kuptohet se edhe kjo punë ishte e përkohshme.
- Vjollca! – thirri ai menjëherë posa hapi derën e banesës dhe, pas një pauze të shkurtër, vazhdoi: - A është dreka gati?!
Vjollca, e cila po punonte, u habit kur dëgjoi thirrjen e Bashkimit dhe doli me shpejtësi nga kuzhina.
Ajo ishte frikësuar shumë nga ajo thirrje, mendoi se mos kishte ndodhur diçka.
- Bashkim, u ktheve?! – pyeti ajo e habitur.
- Erdha të ha vetëm drekë dhe do të shkoj përsëri! – tha ai gëzueshëm.
- Ku? – pyeti Vjollca e habitur. Përse sot ai ishte kaq i gëzuar?
- Në punë, kam gjetur punë! – u përgjigj Bashkimi dhe u ul pranë tavolinës.

Vjollca nuk e vazhdoi më tej bisedën, por hyri në kuzhinë që të përgatiste drekën.
Pas një kohe të shkurtër ajo e ftoi Bashkimin të hynte në kuzhinë për të ngrënë drekën.
Hanin drekë të dy dhe bisedonin të lumtur, për herë të parë pas një kohe të gjatë ishte kthyer buzëqeshja në fytyrat e tyre.
Pas ngrënies së drekës Bashkimi shkoi në punë, kurse Vjollca kryente punët e saj në kuzhinë dhe këndonte.
Fati dhe fatkeqësia banojnë në të njëjtin oborr.
Ditë e zakonshme si të gjitha, rrezet e diellit depërtonin nëpër dritaren e kuzhinës.

Vjollca, ashtu si çdo ditë, kryente punët e saj të zakonshme në kuzhinë, kurse Bashkimi punonte diku në qytet.

Mentori dhe Liridona kishin shkuar secili të kryente obligimet e veta rreth shkollimit.
Vjollca ishte afër lavamanit dhe lante diçka, kur papritur u dëgjua cingërima e telefonit nga dhoma e ndenjes, u ndal për një moment, dëgjoi a ishte vërtetë telefoni dhe, pasi mbylli çezmën, fshiu duart, u nis kah dera e dhomës.
E ngriti receptorin dhe tha: - Alo, urdhëroni!
Një zë gruaje dëgjohej nga ana tjetër e lidhjes.
- Si? – pyeti Vjollca dhe hapi sytë në shenjë habie dhe në fytyrë i vërehej brengosje.
A thua kush ishte kjo që thirri Vjollcën në këtë mëngjes dhe pse e brengosi aq shumë kjo thirrje?
Mos vallë kishte ndodhur diçka me Bashkimin, Mentorin, Liridonën?!
Ç'ishte ajo që e brengosi kaq shumë këtë loke të urtë?
E la receptorin në telefon dhe u ul në karrige, nëpër fytyrë i rridhnin lot pa ndalë, qante!
Qante me zë, sepse nuk ishte askush në banesë ndaj qante lirisht, donte të shfryhej duke qarë.
Po përse qante? Çfarë kishte dëgjuar? Kush ishte ai zë gruaje që e kishte brengosur aq shumë Vjollcën?

Ishte nëna e saj, e cila i kishte treguar se gjendja e të atit ishte keqësuar përsëri dhe se e kishin dërguar në klinikën e kardiologjisë.
Mentori hapi derën e shtëpisë dhe u habit kur dëgjoi të qarët e nënës së tij, u shtang në vend, nuk dinte se çfarë të bënte të hynte apo të kthehej prapa.
Të kthehej nuk mundej, sepse ishte kureshtar të dinte se përse qante nëna e tij. Vendosi të hynte.
- Nënë, pse qan? – e pyeti ai duke hyrë në dhomën e ndenjes.
Vjollca, pasi e dëgjoi, nuk u kthye fare kah ai. Ajo e dinte se kush ishte, pasi e njohu zërin e tij. Pasi fshiu fytyrën nga lotët, u përgjigj: - Gjyshi nuk është mirë.
Këtë e tha ashtu nëpër vaj gati sa duke klithur.
- Prapë sëmurë është?! – pyeti Mentori.
Ajo nuk foli fare, por vetëm pohoi me kokë.
- Ku është, në shtëpi? – pyeti përsëri Mentori.
- Jo e kishin sjellë me ndihmën e shpejtë në spital. – u përgjigj Vjollca.
- Përsëri zemra, apo...? – pyeti.
- Po! Unë po shkoj në spital ta shoh! – tha Vjollca dhe u ngrit nga karrigia.
Pasi fshiu mirë lotët, u rregullua pak dhe doli nga banesa.
Shkoi të vizitonte babanë e saj në klinikën e kardiologjisë.
Vjollca kishte arritur te spitali dhe, derisa ishte duke hyrë brenda, mendonte se në çfarë gjendjeje do ta gjente babanë.
Derisa ecte nëpër korridorin e spitalit, pa disa infermiere që nxirrnin nga dhoma në një kolice

një njeri të vdekur, të cilit i kishin mbuluar gjithë trupin me çarçaf të bardhë.

Ata me kolicen kaluan përreth Vjollcës, e cila u mbështet për muri që t'u lëshonte rrugën për të kaluar.
Vjollca ktheu kokën me një anë, nuk mundej të shikonte.
- O Zot! - klithi ajo, pasi e kaluan infermieret dhe iu drodh trupi nga frika.
Mendonte mos vallë..., jo nuk mundej. Spitali filloi t'i sillej vërdallë. I dukej vetja sikur të kishte hipur në ndonjë barkë të vogël në det të trazuar. Nuk mund të lëvizte lirshëm, i dukej sikur do të rrëzohej në çdo moment.
Në derën e dhomës prej nga e nxorën të vdekurin qëndronte një mjek i ri me syze.
Vjollca me ngadalë, duke u luhatur, u afrua afër tij.
- Më falni, në cilën dhomë gjendet Rufat Veseli? - pyeti ajo me një zë dridhës, sepse frikohej nga përgjigjja që do të merrte.
Frikohej se mos vallë edhe vetë e dinte përgjigjen e pyetjes që parashtroi, se mos vallë ishte vetë dëshmitare e përgjigjes së asaj pyetje.
- Vajza e tij jeni? – pyeti mjeku, pasi e vështroi mirë dhe, sipas pamjes së saj, ai kishte konstatuar se kjo grua që po pyet mund të ishte bija e tij.
- Po! – tha Vjollca duke u dridhur.

- Më vjen keq! – tha mjeku dhe bëri me dorë drejt korridorit sikur donte të thoshte se e patë edhe vetë atë që çuan andej drejt korridorit të gjatë, ishte babai i juaj.
- Si, kur? – pyeti Vjollca dhe lotët filluan t'i rridhnin vetvetiu, edhe pse mundohej të përmbahej dhe të mos qante, sepse i vinte turp të qante.
- Po para një ore! – u përgjigj mjeku, të cilit i vinte shumë keq që po i tregonte këto fjalë kësaj gruaje të urtë.
Por edhe ai i ngrati nuk kishte se çfarë të bënte, ai ishte realiteti sado i hidhur të ishte.
Vjollca u kthye prapa, dalëngadalë duke u mbajtur për muri doli nga spitali, në hyrje të spitalit kishte telefon.
Ajo ngriti receptorin, telefonoi ne shtëpi dhe thirri Mentorin të shkonte atje, sepse vetë nuk mund të bënte asgjë, nuk kishte më fuqi.
Pasi erdhi Mentori në spital, kryen të gjitha formalitetet rreth nxjerrjes së trupit të pajetë të Rufatit nga spitali dhe pastaj kishin shkuar të gjithë në fshat për të kryer varrimin e tij.

Në fatkeqësi njeriu tregon se çfarë brumi është.
Vjollca ishte kthyer nga fshati, por ajo nuk e kishte më atë lumturinë e mëparshme, vdekja e atit e kishte lodhur edhe më tepër. Ishte ulur në dhomën e ndenjes dhe mendonte diçka.
Cingëroi zilja e derës, e cila ia trazoi mendimet që i fluturuan si shpezët kur tremben nga

krisma e pushkës, për një çast të gjitha mendimet u shpërndanë vetëm një i ngeli në kokë, kush mund të ishte te dera?
U çua të hapte derën, ecte me hapa të ngadalshëm.
- Urdhëro, Kumrije! – e ftoi ajo të shoqen e Ramizit.
- Mirëmëngjesi, Vjollcë! – e përshëndeti ajo duke hyrë brenda.
- Mirëmëngjesi! – i ktheu përshëndetjen Vjollca.
Pasi e pyeti për shëndetin e për të gjithë, ajo i shprehu ngushëllimet për vdekjen e të atit, sepse për këtë kishte ardhur.
Të dyja ndenjën ulur për një kohë të gjatë pranë tavolinës në dhomën e ndenjes, biseduan për shumë gjëra, sepse kishin një kohë të gjatë pa u parë.
- Si është Ramizi? – e pyeti Vjollca formalisht, sepse nuk kishte dëshirë të dinte gjë për të.
- Mirë është! E kanë dënuar me dhjetë vjet burg! – tha Kumrija dhe uli kokën sikur të kishte bërë ndonjë gabim, sikur edhe ajo e ndjente veten fajtore.
- Eh, çfarë të bësh! – tha Vjollca që t'i jepte kurajë.
Pasi biseduan edhe pak, Kumrija u ngrit dhe shkoi në banesën e saj.
Vjollca e përcolli deri te dera e banesës dhe, pasi mbylli derën e banesës, u kthye, mori filxhanët ne dhomën e ndenjes dhe hyri në kuzhinë, ngase duhej të përgatiste drekën për Bashkimin.
Jeta është me shumë sfida, të cilat njeriu duhet t'i përballojë.

Njeriu duhet t'i tejkalojë të gjitha vështirësitë nëse do që jeta e tij të vazhdojë e lumtur.
Fati i zgjatë çdo herë dorën guximtarit, kurse fatkeqësitë rrallë vijnë vetëm.
Bashkimi ishte dobësuar shumë, puna e mundimshme prej mëngjesit deri në mbrëmje, sëmundja e lodhte gjithmonë dhe më shumë.
Ai ishte kthyer në banesë dhe ishte shtruar për të ngrënë drekë.
Kishte hyrë në dhomën e ndenjes, ishte ulur pranë tavolinës dhe mendonte diçka.
Sot nuk ishte si herët e tjera, që kur vinte ishte i gëzuar dhe i thërriste Vjollcës, por rrinte ulur dhe mendonte.
- Paske ardhur, Bashkim?! – e pyeti Vjollca, duke dalë nga kuzhina kur pa se ai ishte thelluar në mendime, thjesht që të prish atë monotoni.
- Po, erdha ! – u përgjigj Bashkimi me një zë të mërzitshëm, të lodhur.
Njeriun e humbur në labirintin e jetës, i cili dikur kishte qenë shumë i fortë dhe krenar e me plotë vrull për jetën, e kishin thyer problemet e natyrave të ndryshme.
- Eja në kuzhinë se dreka është gati! – e ftoi Vjollca dhe hyri në kuzhinë.
Bashkimi nuk foli fare, por vetëm u ngrit nga karrigia dhe hyri në kuzhinë me hapa të lodhur.
Bashkimi hante bukë, kurse Vjollca e vështronte dhe sikur donte të thoshte diçka, por nuk dinte se si të fillonte.
Asaj tani i dukej shumë e vështirë ta fillonte bisedën.

- Ti nuk ha? – e pyeti atë Bashkimi kur pa se ajo vetëm është ulur pranë tavolinës dhe e vështronte.
- Jo, do të pres Mentorin dhe Liridonën! – u përgjigj Vjollca, e cila u gëzua pakëz që në këtë mënyrë ai filloi bisedën.
Ja, mendoi ajo, tani është rasti i volitshëm që të bisedoj me të.
Të bisedojë, për çfarë do të kishte biseduar ajo tani me Bashkimin, vallë ka ndonjë fshehtësi që ai nuk e di e kjo tani do t'ia tregojë?
- Bashkim, dua të them diçka! – më në fund ajo mori guximin dhe tha atë që e mundonte gjatë kësaj dite.
- Hë, moj, fol! – tha Bashkimi pa ndërprerë fare të ngrënit dhe njëkohësisht me padurim priste se ç'do t'i thoshte e shoqja. U bë kureshtar, çfarë do të më thotë kjo tani, mendoi ai.
Mendja më tepër i shkonte te fëmijët, Mentori dhe Liridona. A thua mos ndoshta ata kanë bërë diçka të pahijshme, apo mos u duhen të holla për diçka dhe ja, nuk i kanë kërkuar atij, por i kanë thënë nënës që t'ua kryente këtë punë.
- Për nënën time desha të bisedojmë! – tha Vjollca dhe uli kokën sikur të ishte fajtore për diçka, nuk mund ta shihte atë në sy.
E dinte edhe ajo se kjo është një punë shumë e vështirë, por ç'të bënte situata tani e tillë ishte, nuk kishte zgjidhje tjetër.
- Çfarë, të vijë këtu te ne? – pyeti Bashkimi, i cili e kishte kuptuar menjëherë se çfarë donte të thoshte Vjollca.

Edhe ai e kishte të qartë se pas vdekjes së Rufatit nëna e Vjollcës kishte ngelur vetëm në fshat pasi, përveç Vjollcës, ajo nuk kishte fëmijë të tjerë.
- Po, nëse mundet! – tha Vjollca, e cila gjithë kohën e mbante kokën ulur dhe vështronte në dysheme, nuk donte t'i ndeshej shikimi me atë të Bashkimit.
- Po pse jo moj Vjollcë, ne vërtetë jemi ngushtë, por nuk ka problem. Unë nuk e di pse më pyet mua, kuptohet se mund të vijë këtu e të jetojë me ne, ç'do të bëjë vetëm në fshat ajo! – tha Bashkimi duke vështruar Vjollcën.
Atij i vinte shumë keq për të ndaj nuk mund të qëndronte indiferent kur e shihte atë në një gjendje të tillë, sikur të ishte fajtore për diçka.
- E di, por prapëseprapë më mirë është të të pyes! – tha Vjollca dhe ngriti kokën e liruar krejtësisht nga ajo barrë e rëndë që deri pak më parë i kishte peshuar aq shumë.
Asaj i dhimbej Bashkimi, gjendja e tij shëndetësore, puna e lodhshme prej mëngjesit deri në mbrëmje për të siguruar ekzistencën dhe ja tani si barrë e rëndë të vinte edhe nëna e saj të jetonte këtu.

Shkollimi i fëmijëve, harxhimet e tjera për familjen, të gjitha këto duhej t'i siguronte Bashkimi, kurse ajo e dinte shumë mirë gjendjen e tij shëndetësore, ndaj i dhimbsej shumë.

Dhe me ardhjen e nënës së saj do të shtoheshin edhe më tepër harxhimet, mendonte ajo.
Por çfarë të bënte, edhe pse e kishte shumë të vështirë ajo nuk mund ta linte nënën e saj të jetonte në fshat vetëm.
Ajo e dinte që Bashkimi nuk do të thoshte asgjë, se edhe ai do të pajtohej me kërkesën e saj, ajo e njihte shumë mirë Bashkimin.
- Kur të vijë Liridona, le të shkojë në fshat ta ndihmojë të vijë këtu! – tha Bashkimi dhe, pasi lau duart, doli nga banesa.
Vjollca nuk foli fare, por vetëm pohoi me kokë në shenjë pajtimi.
Tani e liruar nga ajo bisedë pozitive që kishte pasur me të shoqin, punonte në kuzhinë dhe pas një kohe të gjatë ndiente përsëri njëfarë gëzimi, njëfarë ndjenje lumturie ia kishte përshkuar zemrën, punonte e gëzuar, por ajo nuk këndonte si më parë kur ishte e lumtur, kur kishte ndonjë gëzim, kur zemra i këndonte vetë.
Tani ajo zemër ishte shumë e lënduar, nuk i këndohej më.
Fytyra i shkëlqente nga gëzimi që më në fund u zgjidh edhe ky problem me nënën e saj.
Mentori dhe Liridona u kthyen nga mësimi.

Lumturia nuk gjendet në pasuri, por në zemër!

Njeriu nuk bëhet i lumtur duke arritur gjërat e vlefshme, por duke arritur çfarë i dëshiron zemra.
Në botë nuk ka njerëz as fare të lumtur as fare fatkeq; më i lumturi e ka një brengë, e më fatkeqi një shpresë.
Ishin ulur të tre në kuzhinë dhe hanin drekën, nuk bisedonin fare, sepse asnjëri nuk dinte se si ta fillonte bisedën.
Nga fundi i ushqimit Vjollca që kishte pritur të mbaronte Liridona ushqimin iu drejtua asaj: - Liridona sot do të shkosh në fshat te gjyshja!
- Te gjyshja, pse? – pyeti Liridona. Ishte bërë kureshtare, mendonte se mos vallë asaj i kishte ndodhur diçka.
Edhe Mentori e vështronte i habitur nënën e tij.
Ai ishte bërë shumë kureshtar dhe mezi priste të merrte vesh se cila ishte arsyeja që nëna e dërgonte Liridonën në fshat.
- T'i ndihmosh gjyshes të përgatisë plaçkat! – u përgjigj Vjollca.
- Ku do të shkojë gjyshja? – pyeti Mentori që priste me padurim përgjigjen.
- Nuk do të shkojë askund, do të vijë këtu te ne. - u përgjigj Vjollca.
- Gjyshja do të vijë këtu? – pyeti Liridona vetëm sa për të vërtetuar atë që tha nëna e saj.
- Por ne jemi ngushtë nënë! – tha Mentori.
- E di bir, por ajo nuk ka se ku të shkojë! – tha Vjollca dhe rrudhi supet.
- E di nënë, e di! Le të vijë, do t'i bëjmë hallin! – tha Mentori dhe buzëqeshi me nënën e tij, sepse ai pa se ajo u mrrol pak në fytyrë kur ky tha se janë ngushtë, se nuk kanë vend.

Pasi kishin ngrënë drekën Liridona kishte shkuar në fshat, Mentori përsëri në fakultet, kurse Vjollca si zakonisht në kuzhinë duke kryer punët e zakonshme të një amvise.
Ishte pasdite. Bashkimi ishte kthyer nga puna dhe rrinte ulur në dhomën e ndenjes dhe, si zakonisht, shikonte diçka në televizor.
Ra zilja, domethënë dikush ishte pas derës. Vjollca u habit shumë kur dëgjoi zilen, asaj filluan t'i sillen në kokë mendime të ndryshme.
A thua kush mund të jetë, Liridona!?
Jo! Ajo nuk kishte nevojë t'i bjerë ziles. Ajo do të hynte menjëherë brenda, por kush është?

Doli nga kuzhina dhe në shenjë habie shikoi një kohë të shkurtër Bashkimin sikur donte të zbulonte në fytyrën e tij atë fshehtësinë se kush gjendej në derë.
Bashkimi vetëm e pa shkurt dhe vazhdoi të shikonte edhe më tej televizorin.
Vjollca, pasi kishte hapur derën, ishte kthyer me shpejtësi në kuzhinë dhe pastaj përsëri me hapa të shpejtë shkoi te dera e hyrjes.
Bashkimi e vërente gjithë kohës këtë lëvizje të shpejtë të Vjollcës herë andej e herë këndej dhe u bë kureshtar, edhe ai tani donte të dinte se kush ishte te dera, mezi priste që të kthehej Vjollca.

- Hë, moj, kush ishte? – pyeti ai, ishte shndërruar i tëri në veshë, mezi priste përgjigjen.
- Paramendo në çfarë derexheje ka ardhur e ngrata! - tha Vjollca.
- Kush, moj, kush ishte? – pyeti përsëri Bashkimi.
- Kumrija! – u përgjigj shkurt Vjollca.
- Ç'kërkonte ajo? – pyeti Bashkimi, të cilit tani përsëri iu kujtua ajo që pati thënë njëherë më parë se me familjen e Ramizit nuk donte të kishte më punë.
- E ngrata kërkoi pak sheqer! – u përgjigj Vjollca.
- Nuk duhet të të dhimbset aq shumë! – tha Bashkimi dhe bëri me dorë sikur donte të thoshte se nuk ka rëndësi.
- Më dhimbset, nuk është fajtore e ngrata! – tha Vjollca përsëri.
- Nuk është fajtore, nuk është fajtore, mos harro se të gjithë ata janë fajtorë për Gëzimin tonë dhe shumë të tjerë si ata! – tha Bashkimi me një tonë më të lartë dhe i mëshoi tavolinës me grusht.
- E di, e di! – tha Vjollca dhe uli kokën, në këtë moment e ndjeu veten fajtore.
Ajo fajësonte veten që e hapi këtë bisedë shumë të dhimbshme për ta.
Sidomos tani që atyre iu kujtua, i ngjallen kujtimet për djalin e tyre, për Gëzimin e tyre që vdiq shumë i ri.
Nuk folën më të dy, për shkak se çdo fjalë u dukej e tepërt, nuk ishte më e nevojshme të vazhdonin bisedën, sepse edhe nuk kishin fuqi të shkëmbenin fjalë rreth kësaj teme.

Droga ishte vrasësja e djalit të tyre.
Aty pak para se të errësohej u hap dera e banesës, në dhomë hynë Liridona me një valixhe dhe pas saj gjyshja.
Ajo ishte një plakë e rëndomtë, e sinqertë, e kërrusur dhe plot rrudha në ballë.
- Erdhëm ne! – tha Liridona gëzueshëm.
- Mirë se erdhët! – përshëndeti Bashkimi dhe u ngrit në këmbë për t'u përshëndetur me plakën.

Plakës i dridheshin duart, mezi qëndronte në këmbë, tani asaj i dukej sikur po i binte tavani i shtëpisë mbi kokë.
E rëndë ishte kjo gjendje për të, por ç'të bënte, ku të shkonte, vetëm në fshat nuk mund të jetonte.
- Nënë, mirë se erdhe! – përshëndeti Vjollca duke dalë nga kuzhina.
Dhe për një çast të dy gratë u hodhën në përqafim.
Ishte ky një përqafim i gjatë që, si dukej, të dyja do të kishin dashur të zgjaste gjithë jetën.
Ishte përqafim plot mall, ashtu siç përqafohen njerëzit që nuk janë parë për një kohë të gjatë.
Por ky ishte edhe përqafim që donte të thoshte se Vjollca ishte e lumtur që nëna e saj do të jetonte pranë saj tanimë.
Derisa këto qëndronin të përqafuara në mes të dhomës Bashkimi dhe Liridona i vështronin dhe në njëfarë mënyre edhe ata e ndjenin veten të lumtur, sidomos Liridona, e cila gati

sa nuk fluturonte kur shihte nënën dhe gjyshen të përqafuara.
- Ngadalë, moj, ngadalë se ja more frymën! – tha Bashkimi duke qeshur.
Këtë e tha vetëm sa për të filluar bisedën dhe që gjyshja të ndihej më e lirë.
Vjollca e lëshoi nënën e saj dhe në atë moment vërejti në faqet e saj disa pika loti.
- Mos qaj nënë, pse qan!? – e pyeti ajo dhe ia fshiu lotët me dorë.
- Ah, moj bijë, pse të mos qaj! – tha plaka.
- Mos qaj gjyshe, ju jeni këtu si në shtëpinë tuaj! - tha Liridona dhe iu hodh asaj në përqafim.
Më vonë të gjithë ishin ulur në dhomën e ndenjes dhe pinin çaj.
Më pas Liridona kishte shkuar në dhomën e saj që të përgatiste vendin për gjyshen, sepse tani do të flinte në dhomë me gjyshen.

Të flasësh pa menduar është si të qëllosh pa marrë shenjë.
Ditët kalonin, pothuajse identike vetëm se në banesën e Bashkimit nuk ishte si më parë.
Aty nuk ishte vetëm Vjollca, por ajo tani rrinte me të ëmën.
Kështu që shpeshherë ato të dyja kur mbeteshin vetëm bisedonin për shumë gjëra, sidomos për të kaluarën në fshat dhe për familjen e tyre.
Bashkimi herë pas here gjente punë në qytet, por kohët e fundit, për shkak të problemeve

dhe sëmundjes së sheqerit, ishte dobësuar shumë.
Fytyra e tij ishte zbehur, çdo ditë merrte injeksione për rregullimin e sheqerit.
Atë mëngjes ai posa ishte zgjuar nga gjumi dhe po hante mëngjesin në kuzhinë.
- Liridona do të shkojë në mbrëmje të maturës! – tha Vjollca sa për të filluar bisedën, sepse nuk mund të kërkonte të holla menjëherë, ngurronte se mos vallë ai nuk do të kishte, e në këtë mënyrë ajo vetëm bënte sprovë, të shihte si do të reagonte Bashkimi.
- Kur e ka maturën? – pyeti Bashkimi, duke ngrënë pa e ngritur kokën.
- Më duket se pas një jave! – u përgjigj Vjollca.
- Me siguri i duhen të holla! – vërtetoi Bashkimi, i cili e kishte kuptuar menjëherë se cili ishte qëllimi i kësaj bisede.
- Po, për mbrëmjen dhe për veshjen e maturës! – tha Vjollca dhe uli kokën, sepse edhe asaj i dhimbsej Bashkimi, edhe ajo e kishte të qartë se e gjithë kjo do të kushtonte ca si shumë.
- Mirë, mirë, sidoqoftë do t'ia bëjmë hallin! – tha Bashkimi dhe u ngrit nga tavolina.
Pasi lau duart, mori kuletën, nxori të hollat dhe ia zgjati Vjollcës.
- Ja 200 euro! Nëse i duhen më tepër më trego! – i tha ai Vjollcës, duke i zgjatur të hollat.
- Mirë, mendoj se mjaft janë! – tha Vjollca, e cila në njëfarë mënyre iu lirua droja se mos vallë Bashkimi do të fillonte të bërtiste.
E kishte të qartë edhe ajo e ngrata se të hollat fitohen me shumë vështirësi.
Pasi u vesh dhe u përgatit për punë, ai doli nga banesa.

Vjollca ngeli vetëm në kuzhinë, sepse të tjerët nuk ishin zgjuar ende.
Në këto çaste, ajo filloi të mendonte për të gjitha çfarë kishin kaluar, nëpër kokë i silleshin ngjarjet më shumë njerëz, por një gjë e mundonte më së shumti, Bashkimi, gjendja e tij shëndetësore, ajo e shihte se kohët e fundit ai po mundohej shumë, gati sa shkonte duke u tretur nga dita në ditë.
Frikohej e ngrata se mos vallë ndodhte më e keqja.
- Mirëmëngjesi, nënë! – e përshëndeti Liridona, e cila sapo ishte zgjuar.
Në atë çast u trazuan mendimet në kokën e Vjollcës dhe si duket ikën kah dritarja e dhomës diku në rrugët e qytetit.
- Mirëmëngjesi, bijë! – i ktheu përshëndetjen Vjollca.
Dhe pastaj vazhdoi: - A është zgjuar gjyshja?
- Po, por si duket nuk është mirë! – u përgjigj Liridona.
- Çfarë kishte, nuk të tregoi? – pyeti përsëri Vjollca.
- Nuk e di, por vetëm më tha se nuk ndjehet mirë! – u përgjigj Liridona.
- Merri këto! – i tha Vjollca dhe i zgjati dorën me të hollat.
- Ç'janë? – pyeti Liridona e habitur.
- Merri këto të holla për maturën! – i tha Vjollca.
Ajo i mori të hollat, ishte e habitur dhe njëkohësisht pendohej, i vinte shumë keq t'i merrte ato të holla, e kishte të qartë edhe ajo e ngrata se në çfarë mënyre i fitonte ato të holla babai i saj.

- A mjaftojnë? – pyeti përsëri Vjollca.
- Po, nënë, madje janë tepër! Nuk kam ndër mend të blej gjë për maturë! – tha Liridona, e cila gjatë gjithë kohës që po fliste me të ëmën kokën e mbante ulur.
- Pse bijë, nuk bën! Duhet të blesh diçka, njëherë në jetë festohet mbrëmja e maturës! – tha Vjollca duke e arsyetuar atë dhe t'i jepte vullnet të behej më e lumtur.
- Po, nënë, por më dhimbset babai! – tha Liridona.
- E di bijë, por, shyqyr Zotit, që ju jeni mirë! - tha Vjollca, e cila mendonte për të dhe Mentorin.
- Të shoh se çfarë ka nëna!? – tha Vjollca dhe hyri në dhomën ku flinte plaka.
Nga dhoma tjetër doli Mentori dhe, kur pa se nëna e tij nuk ishte aty, pyeti Liridonen për të.
- Ku është nëna ? – pyeti ai.
- Në dhomë te gjyshja! – u përgjigj Liridona.
- Pse?! Mos ka ndodhur diçka? – pyeti përsëri ai.
- Jo, por gjyshja nuk ndihej mirë. – u përgjigj Liridona.
Mentori u ul në një karrige dhe priste të dilte e ëma nga dhoma, kurse Liridona po bënte diçka.
Pas një kohë të gjatë u hap dera e dhomës nga e cila doli Vjollca.
- Mirëmëngjesi, Mentor! Qenke zgjuar? – tha ajo kur vërejti Mentorin që rrinte ulur në dhomën e ndenjes.
- Po, nënë! Gjyshja si është? – pyeti ai dhe u kthye kah nëna e tij, sepse ishte i kthyer me shpinë kah ajo.

- Mirë është, vetëm se ndihet e lodhur, plakë është, gjë normale! – tha ajo që të mos brengosen këta për gjendjen e gjyshes se edhe ashtu kishin problemet e tyre dhe pastaj u nis drejt kuzhinës, sepse kishte shumë punë për të kryer.
- Nënë, prit pak! – tha Mentori dhe u ngrit nga karrigia.
Nëna u ndal në vend, trupi iu rrëqeth nga frika, vallë çfarë do të më tregojë ky tani, mos vallë ka ndodhur diçka, ethet ia përshkuan trupin, ishte gati të rrezohet në tokë.
- Nënë, dua të të tregoj diçka! – tha Mentori dhe u afrua afër saj.
- Trego, bir, çfarë ke?! – pyeti ajo plot kureshtje.
- Nënë, kah fundi jam me studimet, por nuk e di kështu më nuk mundem, ngushtë jemi, baba mezi nxjerr të holla, i sëmurë, kam vendosur të shkoj në Gjermani! - tha ai dhe uli kokën, ngase nuk mund ta shikojë drejt e në sy të ëmën.
- Po pse, bir!? – pyeti Vjollca vetëm për të lehtësuar zemrën e saj.

O Zot, sa rëndë tingëlloi në veshët e saj kjo fjalë! Sikur nga qielli i kthjellët ta kishte goditur rrufeja në kokë, gjithçka i sillej vërdallë përreth, do të rrëzohej sikur të mos ishte ulur në një karrige që u gjend aty pranë.
Askush le të mos mendojë se i ikën fatit të vet.
- Nënë, nuk ka tjetër zgjidhje! – tha Mentori.

- Po si do të shkosh, bir?! Atje nuk ke askënd! – pyeti Vjollca tani më pak më e qetësuar, e kishte përmbajtur veten.
- Do të shkoj te vëllai i një shokut! – u përgjigj Mentori.
- Po fakultetin, bir, duhet ta kishe mbaruar! Çfarë do të thotë babai?! –tha Vjollca.
- Fakulteti do të presë pak, do të dal i çrregullt, ndërsa babai nuk ka se çfarë të thotë, sepse për atë po shkoj. Ai është i sëmurë dhe duhet të pushojë, kështu që unë do punoj! Ai nuk duhet të punojë më! – tha Mentori dhe sytë iu mbushën plot lot.
Nëna kur vërejti lotët e Mentorit u ngrit nga karrigia dhe e përqafoi fortë.
- Bir, bëj si të duash, ti e di më mirë! – tha ajo, sepse vërejti brengosjen e tij.
Që t'i jepte kurajë atij, tani bënte sikur ishte e lumtur.

Ishte koha e drekës. Mentori dhe Liridona kishin dalë që moti nga banesa, Vjollca përgatiste drekën në kuzhinë.
Gjyshja ende nuk ishte ngritur, ajo rrinte e shtrirë në shtratin e saj.
Bashkimi hapi derën e banesës dhe hyri brenda. Një çast ai u soll rreth dhomës së ndenjes dhe, pasi pa se nuk ishte askush, dhe pasi e dinte se Vjollca në këtë kohë gjendet në kuzhinë, u nis kah dera e kuzhinës.
- Mirëdita! – e përshëndeti Vjollcën.

- Mirëdita! A u lodhe!? – i ktheu përgjigjen Vjollca.
- Jo shumë! A është dreka gati? – pyeti Bashkimi.
- Po, gati është! – u përgjigj Vjollca dhe bëri me dorë që ishte shenjë se e ftonte të ulet në tavolinë.
Bashkimi, pasi lau duart, u ul pranë tavolinës, kurse Vjollca i shtroi drekën dhe pastaj u ul edhe ajo për të ngrënë.
- Ku është nëna jote, nuk është ngritur? – pyeti Bashkimi.
- Jo, Bashkim, nuk është mirë! – u përgjigj Vjollca.
- Thirri mjekët e vizitës shtëpiake! – e urdhëroi Bashkimi.
- Po, do t'i thërrasë, se me të vërtetë nuk është mirë! – u përgjigj Vjollca dhe pastaj u thellua në mendime, uli kokën dhe mendonte.

Ajo kishte edhe diçka për t'i treguar atij, por si të fillonte tani që ja kanë edhe një brengë tjetër.
Vjollca mendonte se si të fillonte bisedën, si t'i tregonte për vendimin e Mentorit që do të ndërpriste studimet dhe do të shkonte në Gjermani.
Mundohej, nuk dinte se si ta fillonte, t'i tregonte apo ta linte për më vonë.
Kjo e mundonte shumë tani, diçka e rëndonte shpirtin e saj të lodhur, në zemër sikur e

shtrëngonte diçka, çfarë të bënte të tregonte apo jo.
Me bisht të syrit shikonte Bashkimin, i cili kishte mbaruar së ngrëni dhe ishte ngritur të lante duart.
Ajo e vështronte atë nga mbrapa dhe nuk dinte si ta fillonte bisedën.
- Unë do iki se kam shumë punë! – tha Bashkimi.
- Ani! – pohoi me kokë Vjollca, e cila kishte vendosur që për Mentorin të bisedojnë në një rast tjetër, tani nuk ishte momenti.
- Mos harro thërriti mjekët! – tha Bashkimi duke dalë nga kuzhina.
- Mirë, mirë! – tha Vjollca duke u ngritur nga tavolina dhe pastaj filloi ta pastrojë atë, kurse në kokë gjithnjë i sillej problemi me Mentorin.
Nuk dinte e ngrata se si t'i tregonte Bashkimit, atë e mundonin shumë gjëra, i silleshin shumë pyetje nëpër kokë, si do ta pranonte ai këtë lajm, çfarë do të ndodhte me të dhe më në fund ajo frikohej se ai nuk do ta lejonte Mentorin t'i ndërpriste studimet.
Më vonë Vjollca kishte thirrur mjekët kujdestarë për të kontrolluar nënën e saj.
Ata, pasi e kishin kontrolluar, i kishin dhënë një injeksion dhe i kishin lëshuar infuzion që t'i ndihmojë sadopak të mëkëmbet, të mund të çohet, sepse ajo nuk kishte futur asgjë në gojë, nuk kishte fuqi të ngrihet në këmbë.
Ishte diku aty para mbrëmjes, Mentori dhe Liridona ishin kthyer më herët në shtëpi dhe rrinin në dhomën e ndenjes, bisedonin diçka rreth mbrëmjes së maturës që do të festonte Liridona këto ditë.

- Mirëmbrëma! – tha Bashkimi kur hyri brenda.
- Mirëmbrëma! – e përshëndeten edhe këta të dy.
Bashkimi vazhdoi më tej, hyri në kuzhinë, sepse e dinte se Vjollca gjendej aty.
- Mirëmbrëma! – përshëndeti ai duke hyrë në kuzhinë.
- Mirëmbrëma! A u lodhe!? – e pyeti Vjollca.
- Po, pak! – u përgjigj Bashkimi dhe pastaj vazhdoi: - Si është nëna jote?
- Po pak më mirë duket, erdhën mjekët, i dhanë një injeksion dhe i lëshuan infuzion, si duket e kanë ndihmuar pak, por ende nuk mund të ngrihet! – tha Vjollca dhe rrudhi supet në shenjë çudie, që do të thotë se edhe ajo nuk dinte se çfarë do të bëhej me të.

Nuk e dinte se a do ta ndihmonin atë këto apo jo, pasi ajo tani i kishte mbushur edhe vitet, ishte plakë.
Vjollca shpesh thoshte për të se ajo i ka mbushur vitet dhe çdo gjë është e mundur.
- Mirë ke bërë që i ke thirrur mjekët! – tha Bashkimi dhe pastaj shkoi në dhomën e tij që të vesh rroba të tjera, t'i ndërronte ato që kishte për punë.
Pasi ishte veshur ai doli dhe u ul pranë tavolinës në dhomën e ndenjes.
Mentori dhe Liridona shikonin televizorin.
- Mentor, si kalon me studimet? – e pyeti ai.

O Zot, sikur të kishte kuptuar edhe ai për planet e Mentorit, por ç'iu desh që pikërisht në këtë çast ta bëjë këtë pyetje.
Më mirë do të ishte të mos kishte pyetur fare, nuk do ta prishte atë qetësi idilike, por sikur ta kishte ditur se si qëndrojnë punët edhe ai nuk do ta kishte parashtruar në këtë moment këtë pyetje.
Në momentin kur ai pyeti Mentorin nga dera e kuzhinës hynte Vjollca, e cila, kur e dëgjoi, u shtang në vend, sikur iu këputën këmbët, nuk mund të lëvizte, kishte ngelur e shtanguar në vend.

Çfarë do të ndodhte tani, si do të përgjigjej, si do ta pranonte këtë lajm ky, edhe shumë e shumë pyetje të tjera e mundonin tani nënën e shkretë, e cila kishte ngelur në pragun e derës së kuzhinës.
Nuk dinte se ç'të bënte, të hynte apo të kthehej në kuzhinë, të mbyllte derën dhe të mos dëgjonte asgjë.
- Mirë po kaloj, por …! – u përgjigj Mentori dhe u ndal për një çast edhe ai nuk dinte se si ta fillonte, se si të tregonte për vendimin e tij.
- Mentori ka vendosur të shkojë në Gjermani! – tha Vjollca duke u afruar afër tavolinës. Këtë e tha që ta ndihmonte Mentorin, sepse vërejti se ai nuk mund të tregonte.
- Si, pse?! – pyeti Bashkimi i shqetësuar nga kjo që dëgjoi saqë sytë i dukeshin shumë të zmadhuar, sepse ai dhe ishte dobësuar shumë

sa që në këtë moment sytë ishin diçka që dominonin në fytyrën e tij.
- Po, do të shkoj! – u përgjigj shkurt Mentori, sepse edhe ashtu nuk dinte se çfarë të thoshte në atë moment.
- Pse, e fakultetin!? – e pyeti shkurt Bashkimi tani i nervozuar.
- Ngadalë mos bërtit, trego Mentor! – tha Vjollca dhe u drejtua kah Mentori.
- Shih, baba! Unë patjetër duhet të shkoj, ndërsa fakultetin nuk ka problem nga fundi jam, e kryej kur të dua! – tha Mentori me një zë të butë.
- Pse të shkosh, ti nuk ke nevojë, jo, jo nuk mundet! – tha Bashkimi i revoltuar, por tani pak më i përmbajtur.
Vjollca dhe Liridona shikonin herë njërin e herë tjetrin dhe kishin drojë se mos vallë gjendja acarohej edhe më tepër.
- Po, babi, do të shkoj! Ti je lodhur duke punuar në privat dhe ke nevojë për pushim, mjaft ke punuar! – tha Mentori dhe bëri me dorë sikur donte të thoshte "stop" deri këtu e më tutje nuk mundet më.
- Po ku do të shkosh? Edhe atje vështirë është për punë! – tha Bashkimi me një zë të qetësuar.
- Do të shkoj te vëllai i një shokut tim në Shtudgard! – u përgjigj Mentori.
- Ky është i rritur dhe mund të vendosë vetë për fatin e tij! – ndërhyri Vjollca.
- E di, e di, por do të ngelin studimet në gjysmë, të kishe pritur edhe pak sa të mbaroje studimet e mandej shkoje kah të duash! – tha Bashkimi.

- Po, babi, studimet nuk do t'i ndërpres, fakultetin gjithsesi do ta kryej, por pak më vonë! – tha Mentori.
- Mirë, mirë, nëse ke vendosur ashtu, atëherë bëj si të duash! – tha më në fund Bashkimi i qetësuar.
Dalja nga kjo situatë e vështirë i gëzoi pa masë Vjollcën dhe Liridonën.
Të dyja sikur u liruan nga një barrë e rëndë, filluan të merrnin frymë lirisht.
Fytyra e Vjollcës shkëlqente nga gëzimi. Ajo për një çast ndjeu njëfarë gëzimi të pa përshkruar nga ajo se e gjithë kjo mbaroi mirë. Ajo ishte frikuar shumë se mos Bashkimi nuk do të pranonte një gjë të tillë.
- Liridona, shko shih gjyshen! – e urdhëroi ajo.
- Mirë, nënë! – tha ajo dhe u ngrit e shkoi në dhomë ku ishte shtrirë gjyshja.
Në mbrëmje ata kishin ndenjur deri vonë, kishin biseduar për shumë gjëra, për maturën e Liridonës, për shkuarjen e Mentorit në Gjermani e për shumë e shumë gjëra të tjera. Çudi si është njeriu sa pak i duhet dhe menjëherë i harron të gjitha të këqijat.
Njeriu është krijesë e çuditshme, për një çast mund të ndryshojë disponimin e tij.
Edhe anëtarëve të kësaj familje u duhej vetëm një arsye e vogël dhe gjithçka ndryshoi, për një çast u kthye ajo atmosfera e ngrohtë që moti nuk kishte qenë prezent në këtë banesë të vogël.

Ai që pranon këshillat është më i madh se ai që i jep.
Sa është lehtë të japësh aq është e vështirë t'i pranosh.
Këtë mëngjes ky njeri i humbur në labirintin e jetës ishte zgjuar më herët, Vjollca flinte ende.
Por për çfarë arsye ky njeri ishte zgjuar kaq herët dhe kishte kujdes të mos bënte zhurmë, ku do të shkonte kaq herët kur dihet se ai nuk ishte në punë.
Ndërsa sillej nëpër dhomë sikur kërkonte diçka, nëpër kokë i silleshin mendime të ndryshme, më mirë të themi ai bënte plane se ç'do të bënte atë ditë.
Mendimet i silleshin si në atë luhatësen e fëmijëve njëra pas tjetrës.
Këtë mëngjes, pas një kohe të gjatë, iu kujtua djali i tij i ndjerë, Gëzimi, mendonte si, pse, ndodhi ajo me të.
Nga pak ai fajësonte edhe veten, mendonte po sikur të isha interesuar me kohë për të, ta kisha hetuar prej fillimit nuk do të ndodhte ajo që ndodhi.
Por dinamika e jetës kishte ndikuar që ai duke vrapuar pas ekzistencës, fëmijët i kishte lënë pas dore.
Derisa ishte duke kujtuar për të gjitha ato që kishin kaluar, papritur u hap dera e dhomës së fjetjes, ishte Vjollca.
- Qenke zgjuar herët!? – e pyeti ajo Bashkimin.
- Po, kam punë! - u përgjigj Bashkimi.
- Ke punë?! Çfarë pune?! – pyeti ajo përsëri dhe filluan ta mundojnë të panjohurat, çfarë

pune ka, vallë çfarë ka ndërmend të bëj kaq herët.
- Do shkoj të kontrolloj sheqerin! – u përgjigj ai.
- Ah, po, gati se kisha harruar! – pohoi Vjollca.
- Nëna si është? – e pyeti Bashkimi, mendonte për nënën e Vjollcës, e cila ditën e kaluar kishte qenë pak më mirë.
- Po më mirë është, më mirë! – u përgjigj Vjollca.
Pasi u vesh dhe u rregullua, u nis për të dalë nga banesa, sepse nuk mund të hante, ngase do t'i merrnin gjak për analiza.
- Unë ika! – tha ai dhe doli nga shtëpia.
- Ditën e mirë! – e përshëndeti Vjollca nga pas.
Rrugës, ndërsa ecte, përsëri ai ishte i preokupuar me mendime të ndryshme, atij i silleshin nëpër kokë shumë gjëra, por më së shumti e mundonte enigma e shëndetit të tij.
A thua çfarë do të më thotë mjeku, si do të jenë rezultatet e gjakut, mos ndoshta është keqësuar gjendja.
Ai edhe vetë kohët e fundit vërente disa ndryshime, i errësoheshin sytë, i merreshin mendtë, nuk kishte lëvizje të qëndrueshme.
Të gjitha këto tani e mundonin aq shumë saqë filloi të mendojë, të shkojë në ambulancë, apo të kthehej prapa.
Ishte afruar afër ambulancës, kthim prapa nuk kishte, ndaj vendosi të hynte, të kryente këtë detyrë për të cilën kishte ardhur, vendosi të kryejë kontrollin mjekësorë.
Kishte hyrë te mjeku dhe, pasi ai i kishte dhënë udhëzime për te laboratori, shkoi në

laborator dhe pasi i morën gjak për analiza, ai po priste të merrte rezultatin.
Derisa priste në korridor zemra kishte filluar t'i rrihte edhe më shpejtë nga frika, a thua si do të jetë rezultati, çfarë do të më thotë mjeku e shumë pyetje të tjera e mundonin në këtë çast të vështirë për të.
Më në fund e mori rezultatin dhe shkoi përsëri në ordinancën e mjekut që ai të shihte rezultatet.
- Nuk është keq, por ki kujdes, ti nuk duhet të punosh më, të duhet pushim! – tha mjeku.
- Po si të pushoj! Edhe ju e dini gjendjen time! – u përgjigj Bashkimi.
- Po, por shëndeti është në rend të parë, aq më tepër që ju punoni me rrymë, apo jo!? – pyeti mjeku.
- Po! - u përgjigj Bashkimi.
- Në punën tuaj duhet përqendrim maksimal, një gabim i vogël e dini se çfarë mund të ndodhë! – tha mjeku me një zë të butë si prindi kur këshillon fëmijën e tij.
- Po, mirë e keni! – tha Bashkimi dhe uli kokën sikur të ishte fajtorë për ndonjë gabim të bërë.
- Pra, u morëm vesh, ki kujdes dhe sa më tepër pushim! – tha mjeku.
- Po, po! - tha Bashkimi dhe, duke u përshëndetur me mjekun, doli nga ordinanca.
- Si të veprojë? Çfarë të bëjë? A mund të jetohet kështu? - mendonte ai.

Ishte duke u kthyer në shtëpi dhe gjatë gjithë kohës mendonte si të mos punonte, si të jetonte pa asnjë të ardhur. Jeta ka kërkesat e veta! Duhet ushqim, veshmbathje, llogaritë e ndryshme e shumë harxhime të tjera, ndërsa ky duhet të pushonte e të mos punonte.
Por ku do të marrim të holla, mendonte ai, të paktë të ishte njëri prej tyre i punësuar do të ishte më ndryshe.
Mirë, Mentori do të shkonte në Gjermani, por ç'do të ndodhte nëse ai nuk gjente punë dhe nëse e kthenin prapa, atëherë çfarë do të ndodhte me familjen e tij, si do të ekzistonin, si do t'i përmbushnin të gjitha kërkesat e jetës.
Njeri i humbur jam me të vërtetë, mendonte ai, pasi nuk gjente asnjë rrugëdalje tjetër vetëm se të vazhdonte edhe më tej të punonte.
Ai pajtohej plotësisht me këshillat e mjekut, se i duhet pushim, se nuk duhet të punonte më, por si të mos punonte kur familja priste nga ai të siguronte kushtet për jetesë.
Kjo ishte me të vërtetë një gjendje e rëndë psikike për të, si të vepronte kur edhe vetë i vërente simptomat e lodhjes, ishte dobësuar shumë, por nuk kishte zgjidhje, vendosi që edhe përkundër të gjithave ai të vazhdonte të punonte.
Kishin kaluar disa ditë që kishte qenë te mjeku, ai shkonte sërish në punë.
Ishte diku fundi i majit. Liridona e kishte kaluar mbrëmjen e maturës, e cila kishte sjellë në këtë familje sadopak një ndjenjë kënaqësie.
Gjyshja tani ishte pak më mirë. Ajo ditën çohej dhe ecte nga pak nëpër dhomë.

Por Mentori, ai ç'bënte këto ditë?
Ai i kishte përgatitur dokumentet për të shkuar në Gjermani dhe priste vetëm t'i thoshte vëllai i shokut të tij që të niset.
- Bashkim, Mentori niset nesër! – tha Vjollca kur po hanin mëngjesin.
- Ashtu! – vetëm pohoi Bashkimi, sepse edhe ai ishte pajtuar me këtë, nuk kishte se përse të reagonte.
Ajo ishte një punë e kryer.
Deri diku edhe ai në njëfarë mënyre kishte dëshirë që Mentori të shkonte atje, sepse edhe ai e shihte se nuk kishte më fuqi të punonte dhe në këtë çast iu kujtua edhe këshilla e mjekut, se duhet të pushonte.
Por tani e brengoste vetëm një gjë, çfarë do të ndodhte nëse ai atje nuk gjente punë, nëse e kthenin, atëherë çfarë do të bënte ky?
Do të thotë e vetmja shpresë tani ishte Mentori.
Gjithçka mund t'i marrësh njeriut, përveç shpresës.
Pasi hëngri mëngjesin, ai doli nga banesa, sepse kishte për të punuar në një shtëpi në periferi të qytetit ku do të rregullonte rrymën.
Pasi u zgjua dhe hëngri mëngjesin, Mentori doli në qytet, sepse kishte për të kryer edhe disa punë, ai përgatitej për nesër, përgatitej për të shkuar në Gjermani.
Ka gjithmonë arsye ai që dyshon gjithmonë se gabon.
Fatkeqësitë bien gjithmonë përmbi atë që është i lagur.
Bashkimi kishte mbërritur në vendin e punës, kjo ishte një shtëpi dykatëshe, në katin e parë

banonte pronari i shtëpisë, kurse Bashkimi duhej të rregullonte rrymën në katin e dytë, që ishte parregulluar.
Bashkimi u përshëndet me pronarin dhe pastaj hipi në katin e dytë ku e priste puna.
Pasi veshi uniformën e punës, filloi të punonte, mirëpo gjithë kohës i silleshin nëpër kokë shumë gjëra, të gjitha ato ngjarje që kishte kaluar dhe se çfarë do të ndodhte në të ardhmen.
I dobësuar shumë për nga shëndeti, i errësoheshin sytë saqë një punë duhej ta përsëriste disa herë, sepse i harronte gjërat.
Kishte lidhur disa tela rryme në një dhomë dhe provonte nëse kishte rrymë, por rrymë nuk kishte, diçka nuk ishte në rregull.
Pasi hoqi siguresat edhe një herë i zgjidhi telat të shihte se ku ishte gabimi, e kishte përsëritur punën disa herë me radhë, nuk ishte më i sigurt, ndërsa punonte nëpër kokë i silleshin vërdallë të gjitha ngjarjet: vdekja e Gëzimit, shkuarja e Mentorit, matura e Liridonës dhe sidomos takimi me mjekun, fjalët e tij se duhet të pushonte.
Në një moment ishte habitur krejt dhe pa menduar fare nëse i kishte hequr siguresat, zgjati dorën që të kapë telat e rrymës, por për një çast atë e drodhi rryma dhe e hodhi në skaj të dhomës.
Pronari i shtëpisë, pasi kishte vërejtur se në dhomën e tij u ndërpre për një çast rryma, kishte vrapuar menjëherë lartë për të parë se çfarë kishte ndodhur.

- Bashkim, Bashkim! – thirri ai kur vërejti trupin e tij në një skaj të dhomës, të shtrirë në beton.
- Bashkim, ç'ndodhi!? – e pyeste ai më kot dhe duke tundur trupin e tij mundohej ta zgjonte atë, të shihte nëse ishte gjallë.
Por Bashkimi nuk lëvizte fare, atëherë pronari zbriti poshtë me shpejtësi dhe thirri ndihmën e shpejtë, e pastaj kishte hipur sërish lartë dhe gjendej pranë trupit të Bashkimit.
- Bashkim, hapi sytë, fol diçka! – tha ai kur vërejti se i rrihte zemra.
Po, po, ende ishte gjallë, ky njeri nuk dorëzohej lehtë.
Bashkimi për një çast hapi sytë, shikoi të zotin e shtëpisë drejt në sy dhe përsëri i mbylli sytë, nuk ishte mirë.
- Qëndro, Bashkim, qëndro edhe pak ja tani do të vijë ndihma e shpejtë! – tha pronari i shtëpisë tani me një zë më të qetësuar. Ai ishte i kënaqur që nuk ndodhi më e keqja.
Ndihma e shpejtë erdhi shumë shpejtë, ishin një mjek dhe një infermiere, të cilët hipën me shpejtësi lartë, kishin marrë edhe bartësen me vete.
- Gjallë është! – tha i zoti i shtëpisë.
- Më ndihmo ta bartim! – i tha mjeku të zotit të shtëpisë.
Dhe, pasi e vendosën në bartëse, e dërguan deri te vetura, e futën brenda dhe vetura u nis me shpejtësi drejt spitalit.
I zoti i shtëpisë dhe e shoqja e tij ngelën vetëm në oborr.
- Nuk e di ç'të bëj, të telefonoj apo të shkoj vetë në shtëpinë e Bashkimit për t'u treguar

familjarëve të tij për këtë që i ndodhi! – tha i zoti i shtëpisë dhe sikur priste përgjigje nga e shoqja e tij.
- Më mirë do të ishte të shkosh atje! – tha ajo.
- Po, po, më mirë do të jetë, shkova! – tha i zoti i shtëpisë dhe u nis të dalë nga oborri i tij.

Fatkeqësitë janë burim force.
Të gjithë ishin ulur në dhomën e ndenjes, bisedonin rreth shkuarjes së Mentorit në Gjermani, bënin plane se çfarë do të blinin kur do të fillonte ai të fitonte shumë të holla.
Ishin gjyshja, Vjollca, Mentori dhe Liridona, që gjithë kohës bisedonin, qeshnin dhe tregonin planet e tyre për të ardhmen.
Të shkretët as që mund të paramendonin se kishte ndodhur diçka me Bashkimin.
Vetëm se Vjollca kishte njëfarë ndjenje, mirëpo, për hir të atmosferës së krijuar, përmbahej dhe bënte sikur edhe asaj i qeshej.
Ajo gjithnjë mendonte për Bashkimin, kishte drojë se mos vallë ndodhte diçka me të dhe ja në këto momente ajo kishte një ndjenjë të tillë, sikur parandiente atë që i kishte ndodhur Bashkimit.
Ndërsa këta qeshnin dhe bisedonin, ra zilja e derës, të gjithë panë njëri-tjetrin dhe njëkohësisht pyesnin se kush mund të ishte?
Të gjithë e dinin se Bashkimi kur kthehej nga puna nuk i binte ziles, por hynte brenda, sepse derën e linin hapur në atë kohë.

Kush mund të ishte, ndonjë shok i Mentorit që kishte ardhur të përshëndetej me të, apo ndonjë shoqe e Liridonës, inkasatori apo kushdo tjetër e assesi nuk mund të paramendonin se ai do të ishte një person që do t'u sillte një lajm të zi.

Më në fund u ngrit Liridona dhe hapi derën. Para derës ishte një njeri i panjohur për të.
- Mirëdita! Nënën e ke aty? – pyeti njeriu i panjohur.
- Mirëdita! Po, këtu është, urdhëro! – e ftoi Liridona njeriun e panjohur.
Ai ecte nëpër banesë me hapa të pasigurt, plot frikë, mendonte se si ta fillonte bisedën, si t'i tregonte, të tregonte menjëherë frikohej se do t'i trondiste ajo që do të thoshte.
Kur e panë njeriun e panjohur të gjithë u ngritën në këmbë.
- Ju jeni e shoqja e Bashkimit? – pyeti më në fund ai dhe u drejtua kah Vjollca.
- Po! – tha Vjollca, së cilës zemra kishte filluar t'i rrihte me shpejtësi. Tani edhe ajo ishte e bindur se parandjenja e saj nuk ishte e kotë, diçka kishte ndodhur.
Të gjithë ishin bërë veshë, prisnin me padurim se çfarë do të tregonte njeriu i panjohur.
- Bashkimi punonte te unë dhe… - tha njeriu i panjohur dhe u ndal të merrte frymë, sepse nuk dinte se si të tregonte, frikohej se si do të reagojnë familjarët e Bashkimit.

- Fol, ka ndodhur diçka? – pyeti Vjollca plot kureshtje dhe ishte gati të fillonte të qante.
- Po, por tani është mirë! – tha njeriu i panjohur.
- Çfarë ka ndodhur, o njeri, trego! – ndërhyri Mentori, i cili nuk mund të duronte më. Donte sa më shpejtë të kuptonte se çfarë i kishte ndodhur babait të tij.
Vjollca nuk mund të qëndronte më në këmbë, u lëshua në një karrige, nga frika asaj i ishin këputur këmbët, nuk mund të fliste më dhe vetëm dëgjonte se çfarë do të thoshte njeriu i panjohur.
- Duke punuar Bashkimin e zuri korrenti! –tha njeriu i panjohur, i cili tani ishte kthyer kah Mentori, sepse edhe ai nuk kishte më fuqi të shikonte atë zonjë që u ul në karrige.
- Si është, ku është tani? – pyeti Mentori me një zë të frikësuar. Frikohej i ngrati, sepse e dinte se të punosh me korrent nuk është e lehtë, e nëse të ndodh të të zëri korrenti, atëherë është shumë e vështirë të shpëtosh.
- Më mirë është, e dërguam në spitalin e qytetit! – tha njeriu i panjohur dhe uli kokën sikur e ndjente veten fajtor për atë që kishte ndodhur, nuk mund të shikonte asnjërin drejt në sy.
- Po shkoj në spital! – tha Mentori dhe u nis me shpejtësi nga dera.
- Prit, do të vij edhe unë! – tha njeriu i panjohur dhe u nis edhe ai drejt derës për të dalë nga banesa.

Në dhomë ngeli Vjollca me nënën e saj dhe Liridona.
Të dy gratë ishin ulur pranë tavolinës, kurse Liridona ishte kthyer kah dritarja, vështronte qytetin dhe qante në qetësi.
Ajo mundohej të përmbahej, të mos qante, por lotët i rridhnin vetvetiu.
- Mos qaj, bijë! – tha Vjollca kur vërejti se Liridona qante pranë dritares dhe pastaj u ngrit nga karrigia, shkoi te ajo dhe e përqafoi për ta qetësuar.
Por edhe vetë Vjollca gati sa nuk kishte filluar të qante, ajo përmbahej, nuk lëshonte lot, edhe pse zemra e saj qante në heshtje.
Gjyshja i vështronte të dyja dhe vetvetiu plakës filluan t'i rrokullisen lot nëpër faqe, të cilat herë pas here i fshinte me dorë që mos ta hetojnë se qante.
Ajo nuk fliste fare. Kohët e fundit fliste shumë rrallë, e ndiente veten si të tepërt në këtë shtëpi, në vete ajo shpesh e akuzonte veten që ende është gjallë, e mallkonte veten që i pengon njerëzit e kësaj familjeje.
Por me zor nuk vdes dot, pa ardhur dita asnjë njeri nuk mund të largohet nga kjo botë.

Durimi është i hidhur, por frytin e ka të ëmbël.
Fati ia zgjat dorën guximtarit.
Mentori dhe njeriu i panjohur kishin arritur në spital.

Në informacion Mentori pyeti se në cilën dhomë shtrihet babai i tij dhe, pasi i treguan, filloi t'u ngjitet shkalleve përpjetë, pas tij gjithnjë gjendej njeriu i panjohur.
- Babi! – bërtiti Mentori kur hyri në dhomën ku ishte shtrirë babai i tij.
- Mentor! – tha Bashkimi dhe zgjati dorën e djathtë kah ai.
- Si je baba?! – pyeti Mentori dhe e kapi për dore.
- Mirë jam, Mentor, mirë jam! – u përgjigj Bashkimi.
- Po si ndodhi? – pyeti përsëri Mentori.
- Nuk e di as vetë, u humba krejt! – u përgjigj Bashkimi dhe në atë moment vërejti pas shpinës së Mentorit të zotin e shtëpisë.
- Si jeni ju, Lul? – e pyeti Bashkimi atë.
- Mirë jam, Bashkim! Po ti si je? – pyeti Luli duke u afruar afër krevatit të tij, por gjithnjë me frikë sikur e ndjente ai veten fajtor për atë që ndodhi në shtëpinë e tij dhe i zgjati dorën Bashkimit që të përshëndetet me të.
- Mirë jam, siç më sheh vetë! – u përgjigj Bashkimi.
- Shyqyr prej Zotit, mirë qenke! – tha Luli që tani ishte liruar pak, e ndjente veten më të lirë, sepse ishte frikuar shumë se mos vallë ndodhte më e keqja.
- Mentor, ti nesër nisesh, apo...? – pyeti Bashkimi djalin e tij që rrinte pranë krevatit.
- Nuk e di! – tha Mentori dhe uli kokën sikur donte të thoshte se nuk i shkohet pasi ky ishte në spital.

- Ti nesër do të shkosh, nuk ka nevojë të anulosh nisjen, unë jam mirë! – tha Bashkimi me një zë të butë duke buzëqeshur.
- Mentori nuk foli fare, vetëm rrudhi krahët sikur donte të thoshte që nuk e di se çfarë të bëj.
- Ti shko dhe të qoftë rruga e mbarë! – tha Bashkimi dhe i zgjati dorën që të përshëndetet me të për rrugë të mbarë.
Pasi u përshëndet edhe Luli me të, ata dolën të dy nga dhoma e spitalit.
Mentori u kthye në shtëpi ku me padurim e prisnin të dashurit e tij.
- Mirëdita! – tha ai duke hyrë në banesë.
- Erdhe Mentor? – tha Vjollca dhe me padurim priste të tregonte diçka për Bashkimin.
- Po! Babi është mirë! – tha shkurt Mentori dhe u ul pranë tavolinës.
Pas tij u ulën edhe Vjollca dhe Liridona dhe prisnin se çfarë tjetër do t'u tregonte ai.
- Ç'kishte ndodhur? – pyeti Vjollca.
- E kishte humbur mendjen, e kishte zënë korrenti, mirëpo tani ishte shumë më mirë! – tha Mentori.
- Shyqyr, o Zot ! – tha Liridona duke buzëqeshur.
- Mirë, mirë, mund të ishte shumë më keq! – tha Mentori.
Të gjithë tani ishin të lumtur.
Edhe gjyshja që gjithë kohës herë vështronte njërin e herë tjetrin tani e ndiente veten më të lumtur, ishte e gëzuar që nuk kishte ndodhur më e keqja.
- Mentor, nesër do të shkosh, apo...? –pyeti Vjollca.

- Nuk e di, por babi më tha të shkoj! – tha Mentori.
- Po, do të shkosh, pasi është më mirë, nuk ka nevojë të ndalesh! – tha Vjollca dhe u ngrit të përgatisë darkën dhe t'i përgatiste Mentorit diçka për rrugë.
Gjithë atë mbrëmje ata kishin biseduar të gëzuar për shumë gjëra, bisedonin, bënin shaka dhe qeshnin.
Diku vonë kishin rënë për të fjetur pak, për të pushuar, sepse nesër duhej të zgjoheshin më herët për të përcjellë Mentorin.

Ishte mëngjes, të gjithë ishin zgjuar herët.
Çudi, Mentori ishte zgjuar i pari, ose më mirë të themi se ai nuk kishte fjetur fare. Gjithë natën ai kishte menduar për shkuarjen në Gjermani, ku do të vendoset atje, çfarë do të punonte dhe për shumë gjëra të tjera.
- Rruga e mbarë! – e përshëndeti Liridona duke e përqafuar, kurse nëpër faqe iu rrokullisën pika loti.
Pastaj ai përqafoi gjyshen dhe më në fund u përshëndet edhe më nënën e tij.
- Rruga e mbarë, bir! – tha Vjollca dhe përmbahej që të mos qante.
- Mbetshi mirë! – tha Mentori dhe doli nga banesa.
Në banesë ngelën të tria dhe të gjitha qanin, sepse asnjëra nuk fliste, frikoheshin të shikonin njëra-tjetrën se mos vallë vërenin lotët te tjetra, secila qante për vete.

Gjatë kohës kishin ndenjur kështu duke qarë.
Diku aty kah ora dhjetë Vjollca ishte nisur për në spital të vizitonte burrin e saj.
- Bashkim, si je? – pyeti ajo kur u afrua afër krevatit të tij.
- Mirë jam! Mentori iku? – pyeti ai.
- Po, e përcollëm në mëngjes! – u përgjigj Vjollca.
Bashkimi nuk foli fare, ktheu kokën në anën tjetër sikur fajësonte veten për shkuarjen e tij në Gjermani.
Sikur donte të thoshte: unë jam njeri i humbur, nuk mund të siguroj kushte për jetesë, prandaj ai vendosi të shkojë në Gjermani.
- Vetë kishte dëshirë të shkonte! – tha Vjollca kur vërejti se ky brente vetveten. E dinte se kjo është një barrë e rëndë për të, se ky tani fajëson veten për shkuarjen e djalit në Gjermani.
- Po, po! – tha Bashkimi sikur donte të thoshte se e di që vetë ka pasur dëshirë, por këtë e tha me njëfarë ironie.
- Ti si je? Çfarë thonë mjekët? – pyeti Vjollca me qëllim që të largohej nga ajo temë e mundimshme.
- Unë jam mirë! Nesër me siguri do të më nxjerrin nga spitali! – u përgjigj Bashkimi, edhe ky si duket u lirua nga ajo që e mundonte aq shumë.
Pasi biseduan edhe pak Vjollca kishte dalë nga dhoma e spitalit dhe kthehej në shtëpi.
Atë ditë në atë banesë të vogël ishin të pranishme lumturia dhe mërzia.

Nga njëra anë, ata ishin të lumtur që Bashkimi ishte shumë më mirë, kurse, nga ana tjetër, ndienin njëfarë mërzie për ikjen e Mentorit.
Vjollca bisedonte me nënën e saj dhe kryente punët e përditshme.
Liridona kishte shkuar në shkollë.

Të jesh i lumtur me atë që ke dhe do të shohësh se ke mjaft përse të jesh i lumtur.
Vjollca këtë paradite punonte diçka, kur papritur u hap dera e banesës. Ajo dëgjonte për të parë se kush ishte ai që hapi derën e banesës, mos ishte Bashkimi mendonte ajo.
- Mirëmëngjesi! – përshëndeti Bashkimi.
- Mirëmëngjesi, Bashkim, erdhe? – i ktheu përshëndetjen Vjollca.
- Po ja siç më sheh, erdha! – u përgjigj Bashkimi dhe u ul pranë tavolinës.
- A je mirë? – pyeti përsëri Vjollca, e cila kishte ndërprerë punën dhe ishte ulur afër tij.
- Po, më mirë jam! – u përgjigj Bashkimi dhe pastaj vazhdoi: - Të tjerët flenë?
- Po, Liridona dhe nëna flenë - u përgjigj Vjollca.
Atë ditë me të vërtetë ishte kthyer gëzimi në banesën e Bashkimit.
Të gjithë bisedonin, qeshnin, por në mendjet e tyre gjithnjë e kishin edhe Mentorin.

Bashkimi prej sa kishte qenë në spital nuk kishte dalë për të punuar, por gjithë kohën e kalonte në banesë duke pushuar.
Edhe ai e kishte të qartë se me zor nuk shkon asgjë, ishte lodhur shumë, nuk e ndjente veten të sigurt dhe prandaj nuk donte të rrezikonte, ndaj pushonte në banesë.
Nga jashtë u dëgjua një piskamë gruaje, një grua qante.
Bashkimi dhe Vjollca filluan të shikojnë njëri-tjetrin, të dy sikur pyesnin ç'po ndodhte, kush është ajo grua që qanë?
- Vjollca, dil shih kush qan! - i tha ai së shoqes.
Vjollca nuk foli fare, por me shpejtësi u ngrit dhe doli nga banesa.
Bashkimi ngeli vetëm dhe ashtu i vetmuar filloi të mendonte se kush ishte ajo grua që qante, çfarë kishte ndodhur dhe priste me padurim Vjollcën që t'i sjellë ndonjë lajm.
- Kush qante? – pyeti ai Vjollcën, e cila ishte duke hyrë në banesë. Ai nuk kishte më durim të priste që ajo të hynte brenda.
- Qante Kumrija! – u përgjigj Vjollca.
Kur i përmendi emrin e Kumrijes, ai u bë sikur nuk i interesonte asgjë për të, për atë familje, por vetëm thjesht pyeti: - Pse qante?
- Ramizi kishte bërë vetëvrasje në burg! – u përgjigj Vjollca.
- Vetëvrasje?! Mirë, ai njeri nuk meritonte të jetonte! – tha Bashkimi dhe ktheu kokën nga ana tjetër.

- Mos, Bashkim! Mos fol ashtu, edhe ai ndoshta nuk ka ditur gjë për drogën! – i tha Vjollca me një zë të butë lutës.
- Nuk ka ditur, nuk ka ditur Gëzimi jonë që ishte i ri, kurse Ramizi shumë mirë e ka ditur se çfarë dëmi të shkakton droga, por prapëseprapë ka shitur që të pasurohet! – tha Bashkimi me një zë më të lartë dhe me nervozizëm u ngrit nga karrigia dhe filloi të shëtiste nëpër dhomë.
Vjollca nuk foli fare, e pa edhe ajo se çdo fjalë ishte e tepërt.
Nuk kishte nevoje të fliste më, sepse edhe ajo e kishte të qartë se Bashkimi kishte plotësisht të drejtë.
Ditët kalonin, Mentori merrte në telefon, ai ishte mirë, ishte vendosur dhe punonte.
Liridona kishte kryer shkollën e mesme dhe, pasi ishte diku fundi i qershorit, me shoqet dilte ndonjëherë në qytet, por më së tepërmi kohën e kalonte në banesë.
Edhe Bashkimi rrinte në banesë, tani nuk kishte nevojë më të punonte pasi Mentori dërgonte të holla.

Ra zilja, dikush ishte pas derës së banesës, të gjithë ishin ulur përreth tavolinës në dhomën e ndenjes.
Liridona u ngrit dhe hapi derën, u habit shumë kur pa Kumrijen.
- Urdhëro! – e ftoi ajo brenda.
- Babanë aty e ke? – pyeti Kumrija.

- Po, këtu është, urdhëro! – u përgjigj Liridona dhe i bëri rrugë që të hynte brenda.
Vjollcës, kur pa se kush ishte, iu prenë këmbët, frikohej se si do të reagonte Bashkimi, mos vallë do ta përzinte, gjaku i ishte ngrirë në trup saqë në fytyrë nuk i vërehej pikë gjaku.
Bashkimi e shikoi me bisht të syrit dhe ktheu kokën në anën tjetër.
- Mirëdita! – përshëndeti Kumrija të pranishmit.
- Mirëdita, urdhëro ulu! – i ktheu përshëndetjen Vjollca dhe i ofroi një karrige që të ulej.
- A jeni mirë? Bashkim, a je më mirë? – pyeti ajo duke u drejtuar kah ai.
- Po, mirë jam! – u përgjigj Bashkimi shkurt, nuk kishte vullnet të fliste më gjatë.
- Po ti, Kumrije, si kalon? – pyeti Vjollca për të dalë nga ajo situatë e vështirë.
- Mirë jam, por vetëm është e vështirë! – u përgjigj Kumrija.
- Fëmijët si i ke, i ke aty apo jo? Ka kohë që nuk i kam parë! – tha Vjollca.
- Mirë janë! Djali, më duket, është në Itali, kurse vajza është martuar këtu në qytet, ka një vajzë, mirë është. - mbaroi rrëfimin Kumrija dhe sikur u turpërua nga ajo që tha.
- Nuk mbaruan shkollimin? – pyeti përsëri Vjollca vetëm e vetëm që të vazhdonte bisedën, sepse e dinte se, nëse ajo nuk fliste, në banesë do të mbretëronte një qetësi varri.
- Mbaruan shkollën e mesme dhe nuk vazhduan më! – tha Kumrija.

Liridona u solli kafet që kishte përgatitur në kuzhinë dhe, pasi u shpërndau të gjithëve, u ul edhe vete të pijë kafenë.
- Unë kam ardhur për një punë! – tha Kumrija pasi piu pak kafenë.
- Urdhëro, trego! – i tha Vjollca dhe me padurim priste se çfarë do të tregonte, për çfarë pune kishte ardhur.
- Ju e dini se unë jam vetëm. Banesa e madhe nuk më duhet, kam vendosur ta shes dhe të kthehem në fshat te familja ime! – tha Kumrija dhe priste se si do të reagonte Bashkimi, i cili kur dëgjoi se çfarë tha u kthye kah ajo.
- Ne nuk mundemi ta blejmë! – ia priti ai menjëherë, sepse tani e kishte të qartë se ajo kishte ardhur të tregonte se e shiste banesën e saj.
- Sa kërkoni? – e pyeti shkurt Vjollca, vetëm sa për të kaluar radhën, sepse edhe ajo e dinte se nuk kishin aq të holla sa për ta blerë.
- Tridhjetë mijë euro! – u përgjigj Kumrija.
- Mirë është ta blesh, por njëherë nuk kemi! – u përgjigj Vjollca.
- Mirë, unë vetëm erdha t'u tregoj nëse doni ta blini! – tha Kumrija dhe u ngrit të shkonte.
- Prit pak! – tha gjyshja.
Të gjithë u habitën, çfarë kishte kjo tani, pse e ndali, filluan të shikojnë njëri-tjetrin.
- Mbesa ime shko në dhomë dhe në atë valixhen e madhe në një shami kam disa të holla, silli këtu! – tha ajo e drejtuar nga Liridona.
- Nuk e di sa janë, plaku i ka mbledhur, kur ishin marka ishin më tepër e tani këto nuk e di çfarë janë, por janë më pak letra! – tha

plaka dhe në të njëjtën kohë vështronte Bashkimin se si do të reagonte.
Bashkimi dhe Vjollca nuk folën fare, por vetëm buzëqeshën kur kjo tha se më parë ishin më shumë e tani më pak letra.

Liridona e solli shaminë me të hollat dhe e lëshoi në tavolinë para gjyshes.
- Jepja babit! – i tha gjyshja duke treguar me dorë të hollat.
Liridona e mori shaminë me të hollat dhe e la përpara Bashkimit.
Ai e zgjidhi shaminë dhe u habit shumë kur pa se aty kishte shumë të holla.
Por edhe të tjerët ishin habitur aq shumë, sepse nuk kishin pritur që plaka të ketë aq të holla.
Bashkimi filloi të numërojë një nga një, numëronin edhe të tjerët me sy në heshtje.
- Njëzetë e pesë mijë euro! – tha Bashkimi kur mbaroi se numëruari.
- Mund ta blini banesën? – pyeti gjyshja dhe herë shikonte Bashkimin e herë Vjollcën.
- Mungojnë edhe pesëmijë! – tha Vjollca dhe priste se çfarë do të thoshte Bashkimi.
- Nuk ka problem për pesëmijë, ju pres kur t'i bëni! - ndërhyri Kumrija, e cila në këtë moment e ndjente veten pakëz ngushtë.
- Nëse na pret do ta marrim! - tha Bashkimi dhe me padurim priste përgjigje nga Kumrija.

- U bë, nuk ka problem, nesër unë do të filloj të përgatitem për t'u shpërngulur! – tha Kumrija dhe u nis kah dera.
- Prit pak, merri këto të holla! – tha Bashkimi dhe u ngrit dhe ia dha të gjitha të hollat.

Pasi i mori të hollat Kumrija u përshëndet me të gjithë dhe doli nga banesa.
- Nënë, faleminderit shumë! – tha Vjollca dhe përqafoi nënën e saj.
- S'ka gjë bijë, mua nuk më duhet asgjë, ju kam juve! – tha gjyshja duke buzëqeshur.
Edhe Bashkimi qeshte, ishte i gëzuar, sepse edhe ai nuk e kishte pritur një gjë të tillë.
Sa ndryshojnë gjërat në jetë, bota është me të vërtetë shkallë-shkallë, derisa njërit i ndrinë, tjetrit i errësohet dhe anasjelltas.
Bashkimi mendonte se është njeri i humbur kur shihte zhvillimin e Ramizit, mirëpo ai nuk është njeri i humbur, i humbur është ai njeri që punon punë të këqija, kurse njeriu që punon me nder, fiton me djersën e tij nuk mund të jetë i humbur, por ngadhënjimtarë.
Drejtësia ndoshta vonohet, por gjithnjë del në shesh.

Ishte shumë nxehtë, edhe pse ishte mbrëmje. Të gjithë ishin ulur pranë tavolinës në dhomën e ndenjes, shikonin televizorin.

Kishin hapur dyer e dritare, por kot nuk lëvizte asnjë gjethe druri jashtë, nuk frynte kurrfarë ere.
Cingëroi telefoni, u ngrit Liridona, e mori receptorin dhe filloi të bisedojë.
Ishte Mentori.
Ndërsa bisedonte Liridona buzëqeshte gjithnjë, ishte e lumtur që ai ishte mirë.
- Babi, të kërkon Mentori! – tha Liridona dhe i zgjati receptorin.
Bashkimi u ngrit nga karrigia dhe mori receptorin e filloi të bisedojë.
Pas një kohe ai e mbaroi bisedën dhe lëshoi receptorin në telefon.
- Çfarë tha, a ishte mirë? – pyeti Vjollca me padurim, mezi priste të merrte përgjigje, ishte përmalluar shumë.
- Mirë ishte, ju bën të fala të gjithëve! – tha Bashkimi duke buzëqeshur.
- Punonte? – pyeti përsëri Vjollca vetëm sa për të vazhduar bisedën, mandej ajo nuk ishte e kënaqur me atë përgjigje të shkurtër të Bashkimit, donte të dinte sa më tepër për të.
- Po, punonte! Na ka dërguar të holla për pushime! –tha Bashkimi dhe vështronte të tjerët se si do të reagonin.

- **D**o të shkojmë në pushim?! - tha gëzueshëm Liridona.
- Po, do të shkojmë në Strugë! – tha Bashkimi.

Vjollca dhe gjyshja herë vështronin njërin e herë tjetrin dhe zemra u gëzohej kur i shihnin ata të lumtur.
- Vjollca, përgatiti valixhet, nesër do të nisemi! – urdhëroi Bashkimi.
Ky gëzim që u kthye në këtë familje e gëzonte pa masë gjyshen saqë sytë e kësaj plake shkëlqenin nga gëzimi.
Fati ia zgjat dorën guximtarit.
Bashkimi ishte njëri nga ata guximtarë që jeta i kishte sjellë shumë mundime, por ai gjithmonë i përballonte fatkeqësitë. Nga një njeri i humbur, ai në fund është fitimtarë, pas shumë peripecive ai arrin të mëkëmbet, të dalë nga kriza e jetës.
Jeta e tij i ngjante një tuneli në fund të të cilit dukej drita, një dritë shprese për të vazhduar jetën.
Dhe ai doli nga ai tunel i errët, doli në dritën e quajtur shpresë, jeta e tij vazhdonte si më mirë.
Jeta në botë përbëhet nga mendimi, fjala dhe puna; shpëtimi i botës varet nga tri gjëra: të mendosh mirë, të flasësh mirë, të bësh mirë.

FUND